



Npi – 01/52 datë: 05.03.2026

Duke u bazuar në nenin 44 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores së Punës të Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/155 të datës 27.04.2023, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Shtimes e mbajtur më 05.03.2026, është nxjerrë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I Mbledhjes së -I- të rregullt, të Kuvendit të Komunës së Shtimes,
e mbajtur më datën 05.03.2026 (e enjte), në ora 10:00h, në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit z.Rahman Jakupi. Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: z.Rahman Jakupi, Antarët e Kuvendit: z.Grejtalb Emini, z.Besnik Seferi, z.Zenel Shabani, z.Artan Lubovci, z.Faruk Beqa, znj.Uskana Deliu, znj.Adelina Shabani, z.Demokrat Mujota, z.Faik Ramadani, znj.Albana Podvorica, znj.Fatlinda Rrafshi, znj.Arbresha Sylja, z.Bajram Hajrizi, z.Haqif Arifi, z.Shefqet Krasniqi, znj.Frosina Berisha-Ahmeti, znj.Erza Salija, z.Atdhe Isufi, z.Muhamet Ademaj. Përveç anëtarëve të Kuvendit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe Nënkryetari, z.Adnan Ademi; DSHMS, znj.Mimoza Salihu-Qeriqi; DSHP, Halil Kurtishi; DBF, z.Besnik Ahmeti; Zyrtare, znj.Albulena Emini; Zyrtare, znj.Vlora Hyseni, Zyrtarë i IT-së, z.Shpëtim Gashi; Praktikantët, z.Albion Shabani, znj.Hava Llugaxhija, znj.Admir Selmani dhe znj.Teuta Mustafa.

Kryesuesi, z.Rahman Jakupi e njoftoi Kuvendin me rendin e ditës të propozuar si vijon:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 05.12.2025, 31.12.2025, 03.01.2026, 13.02.2026, 17.02.2026,
2. Pyetje - Përgjigje,
3. Shqyrtimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Shtimes për vitin 2026,
4. Formimi i Komitetit për Politikë dhe Financa – KPF,
5. Formimi i Komitetit për Komunitete – KPK,
6. Formimi i Komiteteve tjera,
7. Themelimi i Komisionit të Aksionarëve për KRM “Pastërtia” SH.A., Njësia në Shtime,
8. Themelimi i Komisionit të Aksionarëve për NPL “Ekosistemi” SH.A. – Shtime,
9. Propozim - Vendim për themelimin e Këshillit Komunal për Sigurinë në Bashkësi – KKSB,
10. Raporti Vjetor Buxhetor Janar - Dhjetor 2025,
11. Raporti 9 Muor Buxhetor Janar - Shtator 2025,
12. Raporti i Komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera për vitin 2025 dhe për muajin Janar 2026,

13. Raporti Periodik për zbatimin e Rekomandimeve të ZKA-së,
14. Draft-Rregullore Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2026 (Pas diskutimit publik),
15. Informatë për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2025,
16. Shqyrtimi i kërkesave

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Përshëndetje. Para se të hapi mbledhjen e parë të regullt të Kuvendit të Komunës, siç jeni në dijeni, Qeveria e Republikës së Kosovës ka paraparë që në të gjitha Komunitetet e Republikës së Kosovës të mbahet mbledhje solemne kushtuar shënimit të Epopesë së UÇK-së dhe ne e respektojmë këtë agjendë shtetërore dhe këtë ditë të rëndësishme për vendin tonë. Mirëpo, siç e thashë më parë, duke qënë se mbledhja jonë është thirrur paraprakisht, si mbledhje e regulltë pune, ne do të mundohemi që ta respektojmë edhe këtë ditë, do të mundohemi ta respektojmë dhe agjendën e qeverisë, dhe para se me vazhduar me rendin e ditës, dy fjalë lidhur me këtë ditë, Marsi që e kujtojmë me përlujtje, thellë sakrificën e familjes Jashari dhe gjithë dëshmorëve të tjerë në Prekaz, sidomos rënien heroike të komandantit Adem Jashari dhe familjes së tij, si dhe shumë ushtarë që u bënë themel për lirinë që ne e kemi sot. Shumë dëshmorë të UÇK-së mbeten simboli i qëndresës, sakrificës dhe unitetit kombëtarë. Andaj, për këtë, ju ftoj që gjithë të ngrihemi në këmbë dhe të mbajmë një minutë heshtje kushtuar kësaj dite. Lavdi! Unë kam pranuar edhe një informacion nga Asociacioni Komunal i Republikës të Kosovës, të cilët kanë një kërkesë nga Kuvendi i Komunës që të emërohen dy delegatë, për përfaqësim në Kuvendin e përgjithshëm të Asociacionit të Komunalëve. Pra, kërkoj nga ju, nëse është mundur, që të futët pikë shtesë e rendit të ditës, “Propozim - vendim për emërimin e dy anëtarëve nga Kuvendi”, që të shkojnë në Kuvendin e përgjithshëm të Asociacionit të Komunalëve, ku do të zgjidhet Kryetari i Asociacionit dhe Kryesia. Hap debatin për rendin e ditës.

z.Shefqet Krasniqi: Përshëndetje. Sa i përket pikës së parë procesverbalit, se di po më vjen keq me quajt si vërejtje, por megjithatë, jam pak i befapsur, meqënëse mund të bëhen edhe gabime teknike, në atë çka kam deklaruar unë në procesverbal.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: I nderuar kërkojë ndjesë, vetëm të aprovojme rendin e ditës pastaj diskutojmë për procesverbalin. A keni ndonjë pyetje apo rekomandim për rendin e ditës.

z.Shefqet Krasniqi: Atëherë në rregull, më falni e mora gabim.

z.Haqif Arifi: Përshëndetje. Në rregull, unë i kam dy propozime, pika “Pyetje dhe përgjigje” kisha propozuar që kjo të vendoset në fund, ndërsa pikën e nëntë “Propozim-Vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësisë”, të ndërrohet me Informatën, sepse mendoj që është më logjike, fillimisht me u ndërgju informata. Edhe kisha dasht një scharim lidhur me pikën e fundit. “Shqyrtimi i kërkesave”. Çka nënkupton?

z.Besnik Seferi: Përshëndetje. Në lidhje me zhvendosjen e pikës së dytë ne mendojmë si grup parlamentar që pika e dytë e rendit të ditës, “Pyetje-përgjigje”, të jetë e vendosur në pikën e fundit. Te pika e KKS-së pajtoj plotësisht edhe me diskutimin e parafolës, ku pika “Propozim-Vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësisë” të zëvendësohet me Informatën, sepse e ka logjikën e vet që paraprakisht ne duhet të informohemi e pastaj të vijmë tek formimi i KKS-së. Kam një shqetësim, i nderuari Kryesues, sepse po vërehen, sipas pikave të rendit të ditës, nuk mendoj që je duke përfillur Rregulloren dhe Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, për faktin që nuk po ke konsulta në lidhje me caktimin e pikave të rendit të ditës me Kryetarin e Komunës z.Aliun, veçanërisht me Zyrën e Kryetarit të Komunës. Sa i përket kësaj pikës së fundit, mendoj se kjo çështje është tashmë e rregulluar edhe me vendim që ju pikërisht si pushtet e keni marrë në vitin 2011, ku dhe vendimi shënon qartazi se Kuvendi i Komunës në mbledhjen e parë të Rregullt të vitit 2011, të mbajtur me datën 31.01.2011, unanimisht ka vendosur që kërkesat e qytetarëve që kanë të bëjnë me mjete financiare të adresohen në ekzekutivin e Komunës, përkatësisht në drejtoritë përkatëse. Prandaj edhe rregullorja e parasheh si të tillë. Prandaj, si e tillë ne si grup parlamentar mendojmë që pika e

fundit të jetë pikë e hequr në përgjithësi, dhe të mos vihet prapë si pikë e rendit të ditës. Te themelimi i Komisionit të Aksionorëve të NPL “Ekosistemi” SH.A. dhe KRM “Pastërtia” SH.A. njësia në Shtime edhe këtu mendoj që paraprakisht e keni marrë një hap të ngutshëm, marrë parasysh faktin që me sa e përcakton rregullorja dhe ligjet në përgjithësi, këtu duhet të kemi edhe propozime nga Kryetari i Komunës, sepse duhet me qenë tre anëtarë. Prandaj, si të tilla edhe këtu te këto dy pika mendojmë që duhet larguar si të tilla.

z.Demokrat Mujota: Përshëndetje. Ne e përkrahim iniciativën për ndryshimin e renditjes së pikave të rendit të ditës nga LDK. E sa i përket shqyrtimit të kërkesave, ne qëndrojmë fuqishëm te kjo pikë, sepse kërkesat që i drejtohen dhe adresohen Kuvendit Komunal duhet të vijnë në Kuvendin Komunal dhe jo të mbeten sporteleve të Komunës së Shtimes. Sa i përket pikës shtesë të rendit të ditës që kërkoj Kryesuesi për anëtarët e Asociacionit të Komunave padyshim jemi “Për”.

z.Shefqet Krasniqi: Sa i përket diskutimit të z.Seferi, Kryesus, keni një thirrje juridike, por edhe miqësore që për pikat e rendit të dites, ashtu siç e sheh rregullorja, të konsultoheni edhe me Kryetarin, pavarësisht a i pëlqen njëri-tjetrit apo jo. Andaj jam dakort me z.Seferi që të kordinohemi për rendin e dites, ashtu siç e kërkon rregullorja.

z.Grejtalb Emini: Përshëndetje. Unë pajtohem me disa prej tyre që Pika 7 dhe 8 të shtyhet. Po sa i përket pikës së 16, duhet ta kemi parasysh që e kemi edhe një rregullore të punës së Kuvendit. Rregullorja është që 2 vite që është në fuqi. Në fakt është e vitit 2013 e përbërë nga anëtarët e gjithë subjekteve politike në implementim dhe në formimin e kësaj rregullore. Po ashtu, në nenin 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale e ka dhënë një pasus të qartë, paragrafi 40.3 ku Kuvendi nuk ka mundësi të marrë autorizime ekzekutive. Ka mundësi të japë, por nuk ka mundësi me marrë. Domethënë janë kompetenca të ndame. Nuk bën me u lëshu shumë në këtë çështje. E përmendi edhe Besniku vendimin e vitit 2011 ku nuk kemi nevojë që për një kërkesë për një kanalizim me ardhë në Kuvend me diskutu. Kërkesat e qytetarëve merren në dëgjime publike sa i përket investimeve kapitale, kështu që është e panevojshme.

znj.Albana Hoxha - Pordvorica: Përshëndetje. Nëse më lejohet me diskutu për pikën “Shqyrtimi i kërkesave”, nëse jo vazhdoj kur është kjo pikë e rendit të ditës në rregull.

znj.Yllka Fejzullahu: Përshëndetje. Atëherë unë pajtohem plotësisht me kolegët e mi parafolës, sepse me të vërtetë kjo praktika që ka filluar për rendin e ditës pa u kordinuar me ekzekutivin, mendoj që është shumë absurde dhe e pa lejueshme. Është absurde që ne nuk kemi material për shqyrtimin e kërkesave. Unë nuk e di si mundet me u bërë shqyrtimi i kërkesave, kur nuk kemi material të Kuvendit që na ka ardhë në email, për me i analizuar këto kërkesa. Nuk mundemi ne një kërkesë të qytetarit me e lexu derisa jemi në mbledhje dhe me vendos aty për aty. Kështu që unë konsideroj që patjetër që pika 16 duhet të hiqet. Nëse jo, atëherë ne jemi duke u bërë shkelje të rregullorës së Kuvendit, të cilën e kemi votuar bashkarisht. Vazhdoj me mbështetë fuqishëm edhe faktin që pika “Pyetje – përgjigje” duhet të jetë në fund, me vetë faktin që merr shumë kohë. Dhe tjetra ju lutem që herën tjetër të ketë kordinim të plotë me Zyrën e Kryetarit me Kabinetin, sepse ndryshe më duket si një tentim për vjedhjen e kompetencave të ekzekutivit dhe të Kryetarit dhe njëfarë marrje pushteti.

z.Muhamet Ademaj: Përshëndetje. Faleminderit Kryesues për fjalën. Te pikat e rendit të ditës, shqyrtimi i kërkesave propozoj që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancën e radhës. Besniku e dha arsytimin për këtë pikë sipas rregullorës. Së pari, kjo pikë duhet të shqyrtohet nga ekzekutivi.

z.Grejtalb Emini: Sa i përket pikës së Asociacionit të Komunave, nëse është propozuar si pikë e rendit të ditës, është mire me pas materialin të paktën me ditë, se çfarë çelësi i zgjedhjes së anëtarëve të Asociacionit ekziston. Jo të na paraqitet në seancë këtu pa e ditë cili është çelësi i zgjedhjes së këtyre anëtarëve edhe çfarë kompetenca kanë.

z.Shefqet Krasniqi: Duhet të futet kjo pikë e rendit të ditës. Ne jemi dakord.

Kryesues, z.Rahman Jakupi: I vlerësoj shumë propozimet e gjithë juve që i thatë këtu. Do të ndalem tek temat që u cekën më së shumti e që janë dy. Është çështja e konsultimit të Kryetarit të Komunës për rendin e ditës edhe çështja e shqyrtimit të kërkesave. Ju informoj me përgjegjësi

të plotë që me datën, 18 shkurt 2026, ju kam drejtuar Kryetarit me titull Kërkesë për propozimin e pikave të rendit të ditës, përgatitjen e materialeve dhe draft-agjendës për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës. Në mesin e tyre kanë qenë edhe bashkëpunëtorja profesionale e kuvendit në email, pastaj ka qenë zyrtarja e informimit, znj.Vlora Hyseni. Ka qenë info.shtime që është një email, të cilin besoj që gjithë drejtorit duhet të kenë qasje aty, ka qenë zyrtarja kryesore financiare znj.Kimete Ukaj dhe zyrtari për nënshkrimin e dokumentacionit të Administratë Komonale, z.Shqiprim Hyseni. Ju kam tregu që mbledhjen atëherë e kam planifikuar me mbajtje në fund të shkurtit 2026. Mirëpo unë kam prit një afat ligjor prej 7 ditëve dhe nuk kam marrë kurrfarë përgjigje prej Kryetarit të Komunës. Propozimi për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkisë, që u përmend këtu, më është dërgu përmes bashkëpunëtores profesionale nga Zyra për Informim, por e nënshkruar dhe e vulosur nga ana e Kryetarit. Domethënë ka pas komunikim, komunikimi është bërë përmes bashkëpunëtores profesionale sa i përket kësaj pike, ndërsa nuk kam pas unë përgjigje për rendin e ditës. Domethënë mos u ngutni nganjëherë, se unë u akuzova këtu që s'kam dashtë të komunikoja me Kryetarin. Sa i përket shqyrtimit të kërkesave, është e vërtetë që ka qenë një vendim në vitin 2011 nga pushteti i cili ne kemi qenë atë kohë, mirëpo ai vendim nuk është përfill. Përgjigja është që këto ditë ju gjithë si anëtarë të Kuvendit, por edhe unë si Kryesus i Kuvendit, ne pranojmë kërkesa të ndryshme. Po nuk e di pse, kaq shumë me u frikësu prej shqyrtimit të kërkesave. I di kompetencat shumë qartë sa i përket kësaj. Shqyrtim të kërkesave, ka pas në mandatin e kaluar kërkesa të cilat qytetarët kanë bërë lidhur me emërtimin e rrugëve, që është e drejtë ekskluzive e Kuvendit, mirëpo ajo kërkesë nuk është shfaqur asnjëherë në Kuvend.

z.Besnik Seferi: Unë nuk i qëndroj asaj çfarë thua ti, për shkakë se Kuvendi i Komunës së Shtimës ka pas shqyrtim të kërkesave të qytetarëve për katër vite mandat. Nuk mundesh me thënë sot që na po i shqyrtojmë, sepse po m'dukët pak kjo po luhet si një farë loje, me dal në opinion që ju jeni më shqyrtues edhe domethënë me i analizuar kërkesat e qytetarëve, sepse ne jemi kundër kërkesave të qytetarëve. Nuk është aspak e vërtetë, sepse ka qëndru edhe ka qenë një komision i cili është përbërë prej pesë anëtarëve. Çështja e emërtimit të rrugëve ka qenë një emërtim i cili është bërë në një mënyrë të përgjithshme, procedura si procedurë ka përfunduar. Çështja e emërtimit të objekteve publike janë trajtua të gjitha kërkesat, kemi ardhë në një dakordim, në një konkludim të fundit. Ka pas shqyrtim të kërkesave të ndryshme. Po tu kisha lutë ty si Kryesus, mos me shkel rregullorën të cilën ti vetë e ke votu. Duhet me kuptu kolegë për ata që janë për herë të parë me përvojë, me kuptu që ekzekutivi dhe legjislativi janë pushtete të ndara. I bindur jam që 2-3 takime në muaj duhet me i lënë vetëm për shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve.

z.Shefqet Krasniqi: Të nderuar, së pari kërkojmë mirëkuptim edhe sqarim nga që për ne është hera e parë që jemi në Kuvend. Dhe unë e kam një pyetje miqësore për të gjithë që mundeni me ma dhënë përgjigjen, çështja e shqyrtimit të kërkesave, a kanë kategorizim këto kërkesa? Po mundohem me elaboruar një rast. Nuk e shoh të arsyshme Kuvendi me shqyrtu një kërkesë të një qytetari, nëse kërkon që atje në rrugën e vet apo në rrugicën e vet të vendoset një polic i shtrirë. A mund të kenë kategorizim ose po e marrë në vlerën e shifrave? Po supozoj, nëse një kërkesë bëhet me një shifër prej 2000-3000 euro, për çka t'a shqyrtoj Kuvendi, ose një kërkesë tjetër nëse bëhen mbi një vlerë 10 mijë euro? D.m.th. a kanë kategorizim këto kërkesa?

znj.Arbresha Sylja: Përsëndetje. Po mendoj që nuk ka asgjë gabim, nëse kërkesat e qytetarëve vetëm ju hapet edhe një derë, nuk po thotë askush që këtu Kuvendi merr vendim për me i kompenzuar qytetarët, se e dimë që se ka atë të drejtë. Besnik, kemi qenë bashkë anëtarë të Kuvendit kur çdo kërkesë e qytetarëve është shqyrtuar në Kuvend. Ne nuk po kërkojmë asgjë tjetër, përveç se me ja hap derën qytetarëve, plus të jenë të lirë edhe për të ju drejtuar Kuvendit me një kërkesë specifike. Po pse me pas derën e mbyllur? Mendoj që kjo është një gabim që e keni bërë ju mandatin e kaluar, pavarësisht kush e ka votu. Tash do të jetë e hapur si dera e ekzekutivit, si dera e Kuvendit, se tek e fundit të gjithë jemi këtu për qytetarët.

znj.Yllka Fejzullahu: Duhet me trajtua si temë para se mu votu për me hiq si pikë e rendit të ditës. Po më habit fakti qysh po vazhdoni me e diskutuar diçka, të cilën rregullorja e Kuvendit,

për të cilën gjithë jemi thirrur me zbatuar, po ta ndalon shumë qartë. Nuk keni material në këtë rast për me diskutuar. Edhe çështja tjetër, që Kryesuesi e tha që është kordinuar me Kryetarin, mendoj që nuk është kordinuar te pika 7 dhe 8, ju e dini shumë mirë që në këtë pikë i takon Kryetarit që me pas një kandidat të tij. Unë në material të Kuvendit nuk e pash që Kryetari ka dërgu një emër. Kështu që nuk mundesh me thanë që je konsultu me ekzekutivin, përderisa po të mungojnë materiali që do të vijë nga Zyra e Kryetarit.

z.Demokrat Mujota: Fillimisht më vjen shumë mirë që anëtarët e e Kuvendit e kanë kuptuar ndamjen e pushtetit legjislativ edhe ekzekutiv. E dyta, personalisht me bashkëvendas të mi kemi pas kërkesë specifike për emërtimin e rrugës, që është 1.3 kilometra e gjatë, e kam bërë në vitin 2023 te Drejtoria e Urbanizmit dhe te krejt drejtoritë, vetem te Kuvendi nuk kam pas drejtë me shku. I vetmi vend ku ka drejtë me emërtu rrugë, sheshe, objekte, pika të veçanta është Kuvendi Komunal. Pse na me e blloku këtë rrugë? Pse me mbyllë këtë derë për qytetarët e Komunës së Shtimes?

znj.Albana Podvorica - Hoxha: Veç deshta te kjo pikë te shqyrtimi i kërkesave mendoj që duhet me kon pjesë e Kuvendit. Arsya është kjo, kemi shumë kërkesa të qytetarëve të cilat kanë sëmundje të ndryshme edhe që i kanë dërguar në sportel kërkesat edhe prej këtij rast prej Drejtorisë së Shëndetësisë nuk ju ka kthyer kurrë farë përgjigje. Ata persona trajtohen me sëmundjet çdo javë shkojnë me marr terapi në Prishtinë edhe marrë parasysh kërkesa nuk është shqyrtuar fare prej drejtorisë. Përndryshe, mendoj që kjo pikë është e mirëseardhur në Kuvend.

z.Haqif Arifi: Unë në fillim kërkoja vetëm një sqarim mbi përmbajtjen e kësaj pike. Në rregull më sa dëgjova une prej grupit parlamentar të Vetëvendosjes, disa këshilltarë thonë që janë shqyrtuar, disa thonë që nuk janë shqyrtuar kërkesat. Mirëpo, pajtohem plotësisht me diskutimin e Yllkës, nëse nuk kemi material nuk kemi çfarë me shqyrtuar. Kur nuk ka material, s'kemi nevojë me pas në rendit të ditës diçka me shqyrtuar.

z.Grejtalb Emini: Sa i përket emërtimit të rrugëve, duhet ta kena të qartë. Në vitin 2023 ka ekzistuar një mori e kërkesave të qytetarëve për emërtim të rrugëve, duke e potencuar kërkesën që e bëri parafolësi në fshatin Mollopolc. Kam qenë në kordinim edhe me Arbenin në lidhje me atë rrugë. Nuk ka pas as një njeri kundër mu vendos ai emër. Komisioni e ka kry punën e vet, i ka trajtu gjitha, jo veç Mollopolc por të gjitha fshatrat. Kërkesat për emërtim të rrugëve, Komisioni e ka dërgu në Kuvend. Kuvendi ka marrë vendim. Vendimi i paraqitet Agjensisë Kadastrale të Kosovës për konstatim të ligjshmerisë, përgjegjësishtë Ministrisë së Pushtetit Lokal. Agjencioni Katastral e ka kthyer një pasus që thotë emërtimi i rrugëve, 10 vite nuk guxon me u ndryshuar në asnjë pjesë të komunës së Shtimës. Sa i përket kërkesave tjera për sëmundje, është dobësi me diskutuar në Kuvend për një sëmundje, kur e dimë qartë që mbi ndoshta 50 ose 100 njerëz brenda vitit marrin subvencione

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Veç sa për sqarim edhe për pjesën e Kryetarit është e drejtë ekskluzive e Kryetarit me vendos për anëtarin, me një vendim të tij e kryen këtë çështje. Ne nuk votojmë emër ose nuk mundemi me i treguar Kryetarit kë me dërgu ai ose me votu. Ne e kryejm pjesën e Kuvendit, Kryetari me vendimin e tij e kryen pjesën e vet edhe gjithçka është në rregull. A ka kategorizim të shqyrtimit të kërkesave? Ka në momentin që vjen një kërkesë, vendos Kuvendi po ju tregoj prej përvojës. Nuk e kam plan me shqyrtu kërkesa të cilat janë kompetencë e Kryetarit të Komunës se Ligji s'ma lejon edhe nuk ju qes juve anëtarëve të Kuvendit para aktit me diskutu një pikë të renditi, e cila është pjesë ekzekutive. Kjo praktikë ka ekzistuar në të kalumën. Ka ardh kërkesa është shqyrtuar është pa që nuk i takon Kuvendit. Ju ka transferuar drejtorisë edhe kaq. E hudhë në votim rendin e ditës, siç është propozuar për shkakë se sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, kërkesa e parë e anëtarit të Kuvendit që vjen, hudhet në votim pra kërkesa që pika e dytë e rendit të ditës pyetje-përgjigje të vendoset në fund si dhe Informatë për punën e KKSB-së të vijë para Propozim-Vendimit për themelimin e KKSB-së, si dhe pikën shtesë Zgjedhjen e dy përfaqësuesve për Asociacionin e Komunave të Kosovës.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes me 12 vota "Për" 0 vota "Kundër" dhe 9 vota "Abstenim" miratoi rendi e ditës si në vijim:**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 05.12.2025, 31.12.2025, 03.01.2026, 13.02.2026, 17.02.2026,
2. Shqyrtimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Shtimes për vitin 2026,
3. Formimi i Komitetit për Politikë dhe Financa – KPF,
4. Formimi i Komitetit për Komunitete – KPK,
5. Formimi i Komiteteve tjera,
6. Themelimi i Komisionit të Aksionarëve për KRM “Pastërtia” SH.A., Njësia në Shtime
7. Themelimi i Komisionit të Aksionarëve për NPL “Ekosistemi” SH.A. – Shtime,
8. Informatë për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2025,
9. Propozim - Vendim për themelimin e Këshillit Komunal për Sigurinë në Bashkësi – KKSB,
10. Raporti Vjetor Buxhetor Janar - Dhjetor 2025,
11. Raporti 9 Muajor Buxhetor Janar - Shtator 2025,
12. Raporti i Komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera për vitin 2025 dhe për muajin Janar 2026,
13. Raporti Periodik për zbatimin e Rekomandimeve të ZKA-së,
14. Draft-Rregullore Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2026 (Pas diskutimit publik),
15. Shqyrtimi i kërkesave,
16. **Propozim-Vendim për zgjedhjen e dy përfaqësuesve për Asociacionin e Komunave të Kosovës, (Pikë shtesë)**
17. Pyetje – Përgjigje.

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 05.12.2025, 31.12.2025, 03.01.2026, 13.02.2026, 17.02.2026

Kryesuesi z.Rrahman Jakupi: Fjalën ja dha z.Shefqet Krasniqi.

Shefqet Krasniqi: Atëherë, siç e nisa në fillim, në diskutimin tim sa shkronja mungojnë 307. Sa rreshte mungojnë 6. Dhe pse po e them këtë? Në procesverbal nga ajo që kam thënë, mungon materia, mungon substanca. E keni parasysh. Mungon shpirti i asaj që e kam thënë, edhe humb absolutisht komplet, ajo që unë e kam thanë, të asaj që unë e kam kërkuar. Domethënë nëse marrim me përqindje 90 përqind mungon ajo që e kam thënë në procesverbal.

znj.Fatlinda Rrafshi: Në faqe 13 ka mungesë edhe ndryshim të fjalive. Kisha dashtë që të përmirësohen dhe të rregullohen të gjitha.

z.Haqif Arifi: Gjithashtu në procesverbalin e fundit, në diskutimin e dytë është shumë thelbësore kur kam përmend petitionin. Aty ka qenë, definitivisht kërkesë e qytetarëve kam thënë të familja Ilazi, domethënë nuk është e përshkruar kjo me u vendos gypa me diametër më të madhë ose me u ndërtu një urë.

z.Grejtalb Emini: Sa i përket, diskutimit tim, ju gjithë e dini që unë Yllkën e kam shoqe po edhe fjalimin e keni bërë bashkë, kështu që është mirë me e nda.

z.Demokrat Mujota: E kuptoj që gabimet teknike mundën me qenë jo sot po kanë me qenë edhe nesër dhe pasnesër. Po është mirë secili prej neve me shiku procesverbalin ku kemi biseduar kemi kritikuar ose kemi dhënë alternativa për më mirë. Me i shikuar gjitha këto edhe me gjetë gabimet ku janë, me u drejtua te zyra adekuate edhe me e rregulluar procesverbalin.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Po e hedhë në votim këtë pikë që të gjitha procesverbalet të ndryshohen aty ku mund të ketë gabime teknike ose drejtëshkrimore ose përmbajtësore.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes me 20 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” miratoi Ekstrakt Procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më: 05.12.2025, 31.12.2025, 03.01.2026, 13.02.2026, 17.02.2026, me vërejtjet.**

Pika 2

Shqyrtimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Shtimes për vitin 2026

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Fjalën mund ta marrë kushdo nga anëtarët e Komisionit që ishin.

znj.Adelina Shabani: Përshëndetje. Për sa i përket planit të punës së Kuvendit, ka shku gjithçka në rregull. Ka qenë i përafërt me vitet paraprake që kanë qenë edhe nuk është që ka pasur ndonjë ndryshim aq të madh, kështu që mbetet me u pa për diskutim.

znj.Erza Salihu: Përshëndetje. Unë kam qenë kryesuesja e Komisionit për hartimin e këtij Planit të Punës në bashkëpunim me dy përfaqësuesit e subjekteve tjera politike, nuk kemi pa të nevojshme për ndonjë ndryshim madhor. Ky draft-plan ka pasur ndryshime tejet të vogla për sa i përket informatave.

znj.Yllka Fejzullahu: Atëherë unë falënderoj Komisionin për punën që e ka bërë në hartimin e këtij plani. Ne fakt unë e kam një kërkesë, unë nuk e pash këtu në draft-planin e punës së kuvendit që janë të përfshira dy raportet e Kryetarit z.Qemajl Aliu që i ka ligjërisht të obligueshme për ti dhënë, domethënë dy herë brenda vitit njëra në muajin qershor dhe të tjerat në muajin dhjetor. Besoj këtu ishte një pikë që për mua ishte pak e paqartë. Vetëm pak ta gjej, ishte raport për performancën e Komunës, që nuk e di a e keni menduar të njëjtën, që duhet të jetë raporti i Kryetarit realisht. Kërkesa tjetër është që në maj p.sh. e kemi dy informata, informatë nga DKRS dhe informatë nga DSHMS që nga përvoja mëparshme dy informata brenda një rendi të dites mendoj që e ngarkojnë goxha shumë atë diskutim. E kam pa që tri herë brenda vitit keni lënë informata për me dhënë Drejtoria për Arsime. Për mendimin tim duhet të jetë vetëm në shtator në fillim të vitit shkollor edhe në qershor në përfundim të vitit shkollor, që konsideroj që është e mjaftueshme për për t'i dhënë edhe të hiqet ajo e gushtit.

z.Muhamet Ademaj: Ne e kemi pasur një Komision që ka punuar për hartimin e planit të punës së Kuvendit. E falënderoj Komisionin. Unë e kam një propozim që seancat e Kuvendit të fillojnë nga ora 9 e jo në orën 10 me qëllim që të kemi kohë të mjaftueshme për ta përfunduar seancën paradite. Faleminderit.

z.Grejtalb Emini: Ndoshta është gabim teknik, por sa për sqarim edhe një kërkesë te drejtori i financave. Te muaji Gusht është draft-buxheti i Komunës për vitin 2026. Duhet me qenë për vitin 2027. Edhe në Shtator është shqyrtimi i draft-buxhetit. Është mirë me u shkru votimi i buxhetit për vitin 2027.

znj.Albana Podvorica - Hoxha: Faleminderit, shumë Kryesues. Unë kisha dashtur me pas kërkesë këtu në muajin Qershor, që është informatë nga DKA-ja të jetë raport edhe të vendoset në muajin Korrik, për shkak që nuk mundemi me ditë sa janë të gatshme shkollat me i dërgu raportet për përfundimin e procesit apo të vitit shkollor.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Veç sa u njoftova, që orari i mbledhjeve realisht nuk qenka si pikë e rendit të ditës. Do t'ju vij në mbledhjen e radhës, mirëpo jemi duke diskutuar për Planin e punës. Po e hedhë në votim këtë Plan.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes unanimisht miratoi Planin e Punës së Kuvendit të Komunës së Shtimes për vitin 2026 me këto ndryshime:**

1. Të përfshihen në Plan të Punës së Kuvendit, raportet e Kryetarit,
2. Të vendoset informata nga DSHMS-ja, si dhe nga DKRS-ja në muaj të ndryshëm,
3. Informatë nga DKA për përgatitjet e fillimit të vitit të ri shkollorë 2026/27 të vendoset në Shtator, ndërsa Informatë nga DKA për përfundimin e vitit shkollorë 2026/27 të vendoset në Qershor.
4. Të bëhen disa përmirësime të gabimeve teknike.

Pika 3

Formimi i Komitetit për Politikë dhe Financa – KPF

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Të nderuar anëtarë të Kuvendit, KPF-ja është një prej Komiteteve obligative, i cili parashihet nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale për t'u themeluar si trupat kryesore të Kuvendit. Andaj, pres nga ju që ta respektoni kuotën gjinore, për shkakë se është shumë e rëndësishme.

z.Demokrat Mujota: Unë propozoj që te KPF-ja të jetë formula 2+2+2, plus Kryesuesi që shkon. Kjo është formulë që është e barabartë për gjitha partitë politike në Kuvendin Komunal edhe besoj që është në interes të gjitha partive politike.

z.Muhamet Ademaj: Formimi i Komisionit për Politikë dhe Financa të ketë përfaqësime gjithëpërfshirës për të gjitha grupet politike që janë pjesë e Kuvendit. Kuvendi është, i përbërë nga katër subjekte politike. Sipas udhëzimit administrativ, subjekti politik me numër më të madh të vendeve nga përqindja do të përfaqësohet në Kuvend dhe kështu që vazhdon me radhë partia e dytë, e treta edhe kandidati i pavarur. Po unë i falënderoj kolegët e Vetëvendosjes që e kanë pas mirëkuptim dhe ma kanë dhënë mundësinë që edhe unë me qenë pjesë e këtij Komitetit.

z.Grejtalb Emini: Sa i përket këtij Komiteti, duhet ta kemi të çartë, sipas ligjit, dhe udhëzimet administrative duhet shtatë anëtarë me qenë pjesë. Në udhëzim thotë që duhet të jenë përfaqësues të subjekteve politike grupi më i madhë politik që ka më shumë anëtar, kështu që jemi në rregull sa i përket këtij çelësi. Nuk besoj që ka ndonjë gjë me shtu, por veç me vazhdu me propozime.

z.Besnik Seferi: Unë për këtë, prej anës tëndë nuk pres me bë shkelje, sepse e di ti shumë mirë si bëhet formula. Nuk është këtu fontan dëshirash që ne i dojmë, por thjesht e përcakton udhëzimi administrativ dhe ligji në përgjithësi. Prandaj si i tillë, çelësi duhet me qenë 3+2+ 2.

z.Demokrat Mujota: Ky çelësi i Vetëvendosjes, si duket është interes veç i Vetëvendosjes. Ashtu siç ka qenë edhe në legjislaturën e kalume 2021 - 2025, atëherë kur i ka konvenu Vetëvendosjes z.Ademi u bë kryesus, ka shkuar në KPF si gjithëpërfshirës. Tani vijnë këtu dhe thonë jo se jo, nuk ndodhë. Çelsi është PDK i ka dy anëtar në KPF, VV i ka dy, LDK i ka dy. Kryesuesi është gjithëpërfshirës, siç ka qenë 2021 - 2025 ashtu është edhe sot.

znj.Yllka Fejzullahu: Nëse vazhdojmë kështu, sinjerisht mua më vjen turp me qenë pjesë e Kuvendit që shkel rregulloret, shkel Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzime Administrative është komplet absurde. Duke marrë parasysh që jemi subjekti më i madhë politik, ne tash po duhet me vazhdu tërë kohën me u marrë me dokumente, udhëzime dhe rregullore dhe m'i analizuar pikë për pikë. Kështu që unë po kërkoj që mos me leju me bë këtë shkelje të ligjit kur e keni mundësin ose prit nga MAPL-ja të ju kthen përgjigjen edhe e shihni sa shumë jashtëligjor edhe jo kushtetues keni qenë për këtë.

z.Grejtalb Emini: Unë nuk e besoj që Kuvendi edhe anëtarët e Kuvendit e kanë luksin që mos me u bë zgjedhja e Komiteteve në këtë seancë. Ne prej krejt pikave po pajtohemi që dy trupat e Kuvendit janë shumë të rëndësishme edhe duhet me u formuar. VV-së i takojnë tre anëtarë në Komitet. VV-ja i ka tri propozime. Neni 5 i udhëzimit administrativ është i qartë. Jena subjekti më i madhë politik në Kuvend. I dyti është PDK-ja, i treti është LDK-ja derisa të plotësohet numri prej 7 anëtarëve. Doni me ndryshu formulën? Shkojina në mujin tjetër vijmë prapë te e njejta pikë, të gjithë e dimë saktë përgjigjen e MAPL-së, është formulë ligjore.

z.Shefqet Krasniqi: z.Emini këtu përmendi LDK. LDK është në rregull, ne si LDK jemi interesuar veç të respektohet maksimalisht dhe të zbatohet ligji. Në këtë rast ju merruni vesh mes vete. Ne në këtë rast kemi propozime, s'kemi diçka tjetër. Jemi në rregull, por me rëndësi është që LDK edhe një herë po e përsëriti të mos shkelë procedurat ligjore.

z.Muhamet Ademaj: Unë i kam hulumtuar dy Kuvende. Kuvendin e Obiliqit edhe Kuvendin e Kaçanikut. Ata ishin me numër të njëjtë, siç është Kuvendi jonë, me 21 këshilltar. Kështu që nuk është mirë me hup kohën. E dimë çelsin se ka mundësi që me kthyer edhe MAPL-ja prapë edhe kështu që është mirë që me përfundu.

znj.Yllka Fejzullahu: Deshta me pyet Shefshetin prapë a je jurist apo ekonomist? Eh mirë, dmth infrastrukturen ligjore e kupton shumë mirë. Nëse e kupton infrastrukturën ligjore, unë po besoj që ti shkeljen e ligjit nuk e voton absolutisht.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Vetëm ta lexoj Ligjin për Vetëqeverisje Lokale paraprakisht që qytetëtarët, po edhe ju si anëtarë të Kuvendit të jeni koshient për atë se çfarë po votohet, në vazhdim lexoi Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Udhëzimi Administrativ është një dokument i cili grumbullon numrin e njerëzve që si ju konvenon e bëjnë udhëzimin administrativ. Unë respektoj Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Pse e keni ju brengë nëse ekziston MAPL-ja.

z.Faruk Beqa: Përsëritet. Une veç po du me ju bashkangjit diskutimet të më hershëm. Partia që ka numrin më të madh të asamblistëve në Komunë propozon numrin prej 3 anëtarë. Formula e përcakton këtë. Është e definime edhe në Udhëzim Administrativ. Nëse veprojmë ndryshe e shkelim udhëzimin administrativ edhe ligjin. Kështu që nuk është mirë me shku në Ministritën e

Administrimit të Pushtetit Lokal me shkurt me marrë opinionin tyne edhe ne me u kthyer prapë rishtas me votu sipas ligjit.

z.Demokrat Mujota: Kryesues, mundësisht me lexu edhe njëherë ligjin, ku përcaktohet detyra dhe përgjegjësia e Kryesuesit si Kryesus i KPF-së, e edhe përgjegjësia që kalon nëpër parti politike.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Atëhere më lejoni njëherë ta interpretoj, ta lexoj realisht ligjin se nuk jam i thirrur për me interpretuar. Në vazhdim lexoi përsëri Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Hiq më larg se në Komunën e Prizrenit ata kanë pas të njejtën çështje, kanë bërë shkresë edhe kanë bërë thirrjen në MAPL. Ju e dini që Qeveria e Republikës së Kosovës tashmë ka aprovuar një rregullore komunale për trajtimin e akteve komunale, edhe aty parashihet që për mos me u bërë shkelje ligjore. Këtë rast unë e marrë për obligim, me iu adresu me një kërkesë MAPL-së për me bë një shqyrtim ligjor ose një interpretim ligjor, zyrtarisht prej tyre se si mund të jetë formula. Kjo i bie që Komiteti për Politikë e Financa deri në përgjigjen e MAPL-së me u shty, momentin që e kthen MAPL-ja përgjigjen ne automatikisht takohemi. T'ju informoj edhe për një çështje anëtarë të Kuvendit, e di që është praktikë edhe një praktikë e mirë që njëherë në muaj me u taku, mirëpo për çështje siç është themelimi i trupave të Kuvendit mundemi me u taku edhe më shpesh.

z.Demokrat Mujota: Ne është mirë me realizu çelësin prej 2+2+2 Kryesues. Mandej, Lëvizja Vetëvendosje le të bën kërkesa, apo ankesa në MAPL apo kudo që t'don, ne i marrmi rekomandimet e tyre. Mbi bazën e atyre rekomandimeve, nëse ne kemi bërë shkelje dalim me një rezultat e një konkluzion tjetër.

z.Muhamet Ademaj: Te Demokrati pak du me repliku. Unë e bashkoj votën me LVV-në. Edhe automatikisht na takojn tre këshilltarë mi pasë, në Komitetin për Politikë dhe Financa. Prandaj nëse edhe ju PDK-ja bashkë e bashkoni votën me LDK-në, atëhere ju dalin katër këshilltarë, ju dalin ka dy juve të dyve. Po unë e di që e kthenë MAPL-ja, është veç humbje kohës.

z.Demokrat Mujota: Prof ne ju referohemi rezultateve të KQZ-së, mbi bazën e rezultateve të KQZ-së, ju jeni dikun 300 e pak vota. Ke arritë me u bë asambleistë, po nëse ju bashkoheni me LVV, atëherë bashkohu patjetër, është e drejta jote. Amo ti është dashtë me u deklarë dje pardje, dhe jo sot edhe me qenë ul bashkë me Grejtalbin.

z.Muhamet Ademaj: Unë vetëm për votim po deklarohem që po bëhem bashkë.

z.Grejtalb Emini: Në këtë pikë, të vazhdohet në propozimin prej tre anëtarëve të LVV-së, dy PDK-ja, dy LDK-ja edhe jemi në rregull sipas formulës. Nëse ka propozim tjetër, janë instancat ligjore.

znj.Adelina Shabani: Atëhere deshta mu ndërlidh me Demokratit që tha ta shtyjme për një seancë tjetër edhe ta kuptojmë për çelësin. Por derisa nuk e dijmë këtë çelës si është, atëherë nuk e dimë pse i kërkon tre vende.

z.Besnik Seferi: Me thonë të drejtën qasja e Demokratit nuk po më pëlqen fare hiq, sepse po e luan pak patriotin këtu. Demokrat ne e kemi treguar veten secili, nëse jo unë dhe, dikush tjetër prej familjeve tona ka tregu patriotizëm ku është dashur me tregu. Qasja jote nuk është aspak në përputhje me rregullorën e këtij Kuvendi. Të kisha kërkuar të jesh pak më vigjilent në aspektin e diskutimit dhe asaj se çka po e trajton. Nuk më pëlqeu qasja që ju kundërvihet ashtu Drejtorit të Financave. Ne si grup parlamentar kemi tri propozime, jam unë Besnik Seferi, është Yllka Fejzullahu si dhe Muhamet Ademaj.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Ju kisha kërku që mos me u mirrë fort me çështje terminologjike dhe etiketime të njerëzve, se e dijmë kush sa ka bërë për luftë. I kemi dy variantë me i qitë në votim që kanë ardhur nga z.Demokrat Mujota dhe z.Grejtalb Emini.

z.Shefqet Krasniqi: Flas në emrin timin personal, është mendimi imi personal, nuk flas tani në emër të grupit të LDK-së. Unë konsideroj që nëse është çështje për dy-tre javë, më mirë ta shtyjme këtë pikë edhe të bëjmë një kërkesë për interpretim ligjor nga MAPL-ja.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Kisha kërkuar nga përfaqësues të grupeve politike me diskutu edhe një herë, po ju tregoj unë nuk e bëjë këtë shkresë vet.

z.Shefqet Krasniqi: Atëherë për atë që e thashë mbetet pajtueshmëria edhe e grupit, të LDK-së në tërësi.

z.Demokrat Mujota: Para se me kalu te tema përkatëse, veç deshta me i tregu Besnik Seferit që unë patriot jam qekaq sa jam, qaq sa m'ka bërë Zoti. Nuk jam ardhur këtu me tregu patriotizëm, po jam ardhur këtu me mbrojtë interesat e qytetarëve. Për asnjë moment as nuk pat fyerje, as kurgjo, patëm diskutime. Unë as nuk ofendova, as asnjë gjë. Na mundemi me shty pikën e rendit. Ne duhet me bo një veprim juridik me votë "Pro" ose "Kundër" edhe me kriju provë, që ata me pas brum me çka me trajtu temën.

z.Grejtalb Emini: Sa i përket Kryesuesit të KPF-së, kryesuesi është i njëjtë me të gjithë anëtarët në KPF, mirëpo i përfaqëson entitetet politike në Kuvend. Në këtë rast ai përfaqëson partinë politike prej nga vjen. Nuk është në rregull me bërë lojë, e me thënë Kryesuesi e ka një vend të veçantë. Kryesuesi është pjesë e PDK-së, nuk është i veçantë këtu, ka ardh prej PDK-së, është votuar prej PDK-së. Rasti tjetër, më fal, mas kësaj pike e kena formimin e Komitetit për Komunitete, pse pe ki çelsin aty? Kush po ta jep çelësin? Ta jep çelësin udhëzimi administrativë, apo? Qysh ta jep edhe për KPF?

znj.Yllkë Fejzullahu: Fillimisht nuk m'u pëlqen aspak tendenca e Kryesuesit, që po hezitoni me m'a dhënë fjalën sa herë po e kërkoj. Sa i përket çështjes që po e diskutoni, që Kryesuesi paska një vend eksplicit në Kuvend, kryesuesi i Kuvendit është veç një udhëheqës i Kuvendit, është asambleist, anëtar i Kuvendit njëjtë si unë, si Besniku si gjithë tjerët. Nuk ka kurrfarë kompetence tjetër përveç udhëheqjes së mbledhjes. Singërisht, une vetë jam juriste edhe po vazhdoj me thanë që po ndihna keq, që po vazhdojmë me shkelje të tilla të rregulloreve. Pra është absurde që Lëvizja Vetëvendosje me numrin më të madhë të anëtarëve të barazohet me partitë e tjera që kanë numra më pak, është absurd në vete kjo, kjo që po e kërkon. Tjetra, tendenca e Demokratit, ja përmenda emrin, ka drejtën e replikës, mënyrën sesi ai po e trajton Kuvendin, singërisht më duket shqetësuese. Ne mundemi me kërkuar nga MAPL-ja opinion ligjor edhe jam e bindur që ka me u kthi në favor tonin.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Ska tendenca e as arrogancë as çështje tjera. Ju ftoj që të përgaditeni për votim. Unë do të hedhë në votim propozimin që të hartojë shkresën dhe ta dërgoj në MAPL për shqyrtim paraprak.

z.Faruk Beqa: Mirë është me e bërë shkresën në MAPL për të gjitha komitetet dhe komisionet me dhënë interpretim, dhe me caktu çelësin.

z.Shefqet Krasniqi: Ndëgjoni, ne nuk jemi për me shkelë ligjin. Andaj kërkesa ime miqësore është ashtu siç e potencoi edhe koleg-ja nga Lëvizja Vetëvendosje. Nëse unë e kuptova drejtë, ta bëjmë një kërkesë në MAPL për interpretim ligjor. Unë miqësisht po kërkoj që të shtyhet.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Po e hedhë në votim propozimin që kjo pikë e rendit të ditës të shqyrtohet pas përgjigjes nga MAPL-ja.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht vendosi që pika e rendit të ditës me numër 3 "Formimi i Komitetit për Politikë dhe Financa" të shtyhet për shqyrtim, deri në mbledhjen e radhës të Kuvendit, me arsyetimin që Kryesuesi i Kuvendit të kërkojë opinion ligjor nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal lidhur me çelsin për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.**

Pika 4

Formimi i Komitetit për Komunitete

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: A jeni të pajtimit që të i propozoni emrat dhe të themelojmë Komitetin për Komunitete? Fjalën ja dha znj.Albana Podvorica Hoxha.

znj.Albana Podvorica – Hoxha: Atëhere nëse është çelësi me 1, unë i kisha propozu që secili subjekt me e propozuar nga një anëtarë dhe ta përfundojna këtë pikë, mos ta shtyjmë. Nuk më duket në rregull.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Mund të vazhdojmë me propozime nga grupet parlamentare.

z.Grejtalb Emini: Propozojë z.Artan Lubovci nga LVV-ja.

z.Demokrat Mujota: Nga PDK-ja propozojmë znj.Fatlinda Rrafshi.

znj.Frosina Berisha Ahmeti: Nga LDK-ja propozojmë z.Haqif Arifi.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Pra kemi tre propozime, z.Artan Lubovci, znj.Fatlinda Rrafshi dhe z.Haqif Arifi. Po ju informoj me rradhë për propozimet që na kanë ardhur nga Komunitete pakicë. Janë gjithsej 6 propozime 1. Arton Demiri, përfaqësues nga Komuniteti Rom, 2. Arjeta Maliqi përfaqësuese nga Komuniteti Egjiptian, 3. Sabrije Velu përfaqësuese nga Komuniteti Ashkali, 4. Bajram Ilazi përfaqësuese nga Komuniteti Ashkali, 5. Rrahman Kadrija përfaqësues nga Komuniteti Ashkali, dhe 6. Sefedin Tahiri përfaqësuese nga Komuniteti Ashkali.

znj.Yllkë Fejzullahu: Unë realisht mendova që e njëjta do duhet të vrente edhe për Komitetin për Komunitete edhe për Komitete tjera. Konsideroj që është e rrugës që në momentin që kërkojmë interpretim, ti kërkojmë për çelësin e dy Komiteteve të përhershme dhe tri tjera që nuk janë të përhershme. Sepse po më duket pak njëfarë laramanie e panevojshme. Të kërkojmë interpretim ligjor për të trijat nga MAPL-ja, të jemi të sigurt që jemi në rregull nga ana ligjore. Pastaj në seancën e radhës i sjellim prapë për votim, duke pasur çelësin vetëm i delegojmë emrat edhe i votojmë.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Vetëm një sqarim, te Komiteti për Politikë dhe Financa nuk patëm dakordim, mirëpo te Komiteti për Komunitete kemi dakordim edhe këtu besoj që s'do të ketë shkelje ligjore. Kemi propozime më shumë sesa që duhet, po automatikisht të dy vajzat ose gratë shkojnë pastaj prej partive politike kemi Rrahman Kadrija. Prej Komitetit rom e kemi Arton Demiri. Është çështja për dy propozime tjera që vijnë Bajram Ilazi dhe dhe Sefedin Tahiri.

znj.Arbresha Sylja: Me automatizëm për shkak të kriterit ligjor, dy femrat po duhet me shku, ndersa anëtarë të tjerë që janë nuk e mora informacionin si janë propozuar. Ndoshta ka qenë mirë që na me i hudh në votim si emra të përvetshëm nëse dojmë që t'i kalojmë, se përndryshe kishte me qenë e padrejtë nëse ne vendosim kështu në grup. Disa të jenë disa të mos jenë.

z.Besnik Seferi: Duhet ta bëjmë një shtyrje të pikës edhe për Komitetin për Komunitete, po ashtu edhe për Komitete të tjera, duhet me kërku interpretim ligjor. Sepse në Komitetin për Komunitete kemi katër pesë kërkesa nga organizatat të ndryshme joqeveritare në kuadër të komiteteve Ashkali dhe Romë të Komunës së Shtimes, përfshirë këtu edhe subjektet politike, si të tillë duhet me kërku dhe një interpretim ligjor nga MAPL-ja edhe për trajtimin e kësaj pike që është shumë me rëndësi. Sepse jemi duke bërë njëfarë laramanie, mos dakordimi të duhur.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Nuk e di a jam mjaftueshëm i qartë. Nuk e di çka me kërku prej MAPL-së une për çështjen e Komiteteve. Tani e kemi edhe një propozim tjetër është Gyltene Osmani-Ilazi, shtatë propozime janë për Komitetin për Komunitet, katër kemi me i zgjedhë.

z.Grejtalb Emini: Sa i përket, këtij Komiteti, veç me e ditë sa përfaqësues kena prej komuniteteve që kanë ardhë zyrtarisht edhe sa i kena prej shoqërisë civile. Interpretimi ligjor na duhet nga MAPL-ja për me ditë zyrtarisht cilat kërkesa mundemi me i marrë ne.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Ne si subjekte politike këtu qe jem, gjithë po pajtohemi që me pas nga një përfaqësues, kuotën gjinore po e plotësojmë. Tani na mbetet me i zgjedhë edhe dy anëtarët tjerë edhe mbaron kjo çështje.

z.Haqif Arifi: Meqenëse ka propozime prej jashtë Kuvendit. Nuk e di sa është proceduralisht në rregull me i përgadit që këta me i votu me votë të fshehtë. Ata që janë jashtë Kuvendit është fjala, sepse për këta të Kuvendit veqse është çelësi.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Nëse Kuvendi vendos ne mundemi me shkuar me votim të fshehur për këta persona.

z.Muhamet Ademaj: Thashë që zgjedhja e anëtarëve të Komitetit për Komunitete të bëhet me propozimin e kandidatëve të ofruar nga Komuniteti jo shumicë. Është mirë që me kërkuar interpretim ligjor pasi që ka shumë shumë propozime prej një Komuniteti.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Po veç unë nuk e kam të qartë çka kam me i kërkuar unë MAPL-së. Në Komitetin për Politikë Financa ishin dy propozime për çelës. Këtu është ndryshe.

z.Besnik Seferi: Po më vjen keq që po ripërsëritet kjo pikë. Po këtu sigurisht që kanë përparësi ata që janë të propozuar nga partitë parlamentare, të tjerat i kemi nga organizata të ndryshme. Ne numrin po e dijmë që është 4 nuk mundemi me dal përtej atij numri, po thjesht të interpretohet se kush ka përparësi në këtë rast, propozimet nga partitë parlamentare apo nga organizatat. Mendoj që edhe kjo pikë duhet me u shty meqenëse po thirreni që mos me bë shkelje ligjore.

z.Haqif Arifi: Kandidimi është e drejtë e pakontestueshme secilit, ne nuk mundemi me ja ndaluar askujt.

z.Demokrat Mujota: Ka kandidatë që janë ashkali, e që vijnë me kandidu me parti egjiptiane. Në Shtime nuk ka egjiptan, ka romë, ka ashkali, po jo edhe egjiptan. Besniki po i referohet partisë egjiptiane që është në Qeveri.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Shtatë propozime i kena nëse dëshironi mundemi me votu me vota të hapura, ose nese dëshironi votimin mundemi me bë në mënyrë të fshehur. Kjo është mire. E kemi edhe propozimin për shtyrjen e kësaj pike po e hedhë në votim.

Në këtë rast kemi 9 vota "Për", 9 vota "Kundër" dhe 0 vota "Abstenim", dhe unë po e përdorë votën e dyfishtë të Kryesuesit, kjo pikë nuk shtyhet.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes me 10 vota "Për", 9 vota "Kundër" dhe 0 vota "Abstenim", (me votë të dyfishtë të Kryesuesit) nuk e miraton propozimin për shtyrjen pikës "Formimi i Komitetit për Komunitete".**

z.Faik Ramadani: Fatkeqësisht une nuk e njoh asnjë prej këtyre personave të propozuar. Edhe tash e kemi shume problem ne këtu kënd me votu, kënd mos me votu se ata dikush i ka delegu. Neve na erdhen edhe 2-3 emra tjerë dhe na u kan bë 7 emra. Kur i patëm ne veç 4 emra lehtë e kishim mu pajtu. Me zgjedhë nga një prej Kuvendit edhe me plotësu Komitetin. Por në këtë rast mu po më duket shumë e padrejtë. Unë personalisht flas për vete, unë nuk e di kush janë ata njerz edhe çka përfaqësojnë.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: A të shkojmë me votim të hapur për secilin veq e veq apo të mbyllur. Unë jam për votim të mbyllur sepse kemi 7 propozime.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes me 9 vota "Për", 0 vota "Kundër" dhe 10 vota "Abstenim" miraton propozimin për Formimin e Komitetit për Komunitete me vota të fshehura.**

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Atëherë e lus Sekretarin e Kuvendit si dhe të gjithë anëtarët që të përgaditen për votim. Pasi që jemi gati, duhet të formohet një Komision votues ju lutem subjektet politike që të i jepni propozimet e juaja.

z.Besnik Seferi: Ne propozojmë znj.Adelina Shabani nga LVV-ja.

z.Demokrat Mujota: Nga PDK-ja propozojmë znj.Albana Podvorica- Hoxha.

z.Shefqet Krasniqi: Nga LDK-ja propozojmë znj.Frosina Berisha-Ahmeti.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Në rregull po i hedhë në votim këta emra.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi zgjedhjen e Komisionit Votues për përcjelljen dhe numërimin e votave për formimin e Komitetit për Komunitete në këtë përbërje:**

1. znj. Adelina Shabani - LVV,
2. znj.Albana Podvorica- Hoxha- PDK,
3. znj. Frosina Berisha Ahmeti – LDK.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Atëherë Komisioni mund të fillojë me punën pas konstatimit se çdo gjë është në rregull me fletëvotime.

znj.Frosina Berisha- Ahmeti: Atëherë pasi kemi konstatuar se janë 21 fletëvotime, i ftojme asambleistët të vijnë me radhë për të marrë fletëvotimin. Votimi është përfunduar tani vazhdojmë me numërimin e votave.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Atëherë po ju komunikoj rezultatin, kemi me 15 vota Bajram Ilazi, pastaj me 18 vota është Gyltene Osmani- Ilazi, kemi Rrahman Kadrija me 12 vota, Sabrie Velu me 13 vota, Arton Demiri me 12 vota, si dhe Arjeta Maliqi me 10 vota. Në votim janë të barabartë Arton Demiri dhe Rrahman Kadrij. Ne kemi filluar votimin e fshehur mendoj që duhet me vazhduar.

z.Haqif Arifi: Nuk kemi çka me u mirrë vesh, kemi filluar me votim të fshehur. Është procedurë që nuk mundemi me lënë në gjysmë.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Po e hedhë në votim propozimin që të vazhdohet me votim të fshehtë, edhe për këta dy kandidatë.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 10 vota "Për", 0 vota "Kundër" dhe 9 vota "Abstenim", miraton propozimin që të shkohet në rivotim për kandidatët z.Arton Demiri dhe z.Rrahman Jakupi që kanë rezultate të barabarta.**

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Fjalën ja dha z.Faruk Beqa.

z.Faruk Beqa: Kushtimisht po themi është me udhëzim administrativ, në Komitetin për Komuniteti duhet të përfasohen komunitetet. Këtu ne kemi komunitetin ashkali, romë, mandej të tjerët më duket janë të shoqërisë civile. Tash këto dy komunitete praktikisht shkojnë automatikisht, në Komitetin për Komunitete.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Vazhdojmë me rivotim. E ftojë Komisioni Votues që ta marrë vendin e tyre.

znj.Frosina Berisha Ahmeti: Atëherë po vazhdojmë, kemi 21 fletëvotime të vlefshme. Pa humbur kohë, ftojme anëtarët që të marrin fletëvotimet.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Sipas rezultatit që kanë konstatuar Komisioni votues, e kemi këtë rezultat, Rrahman Kadrija është me 11 vota, dhe Arton Demiri me 10 vota. Kështu që sipas tij rezultati Rrahman Kadrija mbetet si më i votuari në Komitetin për Komunitete.

znj.Yllkë Fejzullahu: Pavarësisht se e bëmë formën e votimit me atë sa unë e kuptova edhe nga personat që kanë pasur përvojë në zgjedhjen e komiteteve më herët, Arton Demiri është i vetmi përfaqësues nga komuniteti rom, i cili sipas voteve tani nuk ka hyrë në përbërjen e Komitetit për Komunitetet, çka përbën shkelje sipas mendimit tim. Natyrisht që edhe ky vendim do të shqyrtohet nga MAPL-ja, por unë do të kërkoja edhe nga Sekretaria e Kuvendit që edhe për këtë çështje të kërkoj interpretim ligjor, sepse thjeshtë po më duket se është bërë një e padrejtë, ku nuk kemi përfaqësues të komunitetit rom.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Atëherë po i lexojë edhe njëherë të gjithë emrat, nga LVV-ja është z.Artan Lubovci, nga PDK-ja Albana Podvorica-Hoxha, dhe nga LDK-ja z.Haqif Arifi. Nga komunitetet janë z.Bajram Ilazi, znj.Gyltene Osmani-Ilazi, znj.Sabrie Veliu si dhe z.Rrahman Kadrija. Atëherë meqenëse votimi për përfaqësues të Komuniteteve është kryer në mënyrë të fshehur po i hedhë në votim, vetëm emrat e anëtarëve të Kuvendit.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi vendimin për zgjedhjen e anëtarëve të Kuvendit si anëtarë të Komitetit për Komunitete, në këtë përbërje:**

1. z.Artan Lubovci – LVV,
2. znj.Albana Podvorica – Hoxha – PDK,
3. z.Haqif Arifi – LDK.

Ndërkaq me vota të fshehta nga përfaqësuesit e Komuniteteve, Kuvendi ka zgjidhur 4 anëtar të Komitetit për Komunitete si vijon:

4. znj. Gyltene Osmani-Ilazi (Kom. Ashkali) – 18 vota,
5. z. Bajram Ilazi (Kom. Ashkali) – 15 vota,
6. znj. Sabrije Veliu (Kom. Ashkali) – 13 vota.
7. z. Rrahman Kadrija (Komuniteti Ashkali) me 11 vota.

Pika 5

Formimi i Komiteteve tjera

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Edhe në mandatin e kalum kanë qenë të themeluara këto Komitete, mirëpo gjatë rrugëtimit nuk kanë qenë funksionale. Çështja e pagesës, vendimi ka shku në Ministrinë e Financave për shqyrtim ligjor dhe do të kthehet, mandej do ta prezantoj para jush të gjithë që jeni prezent këtu. Edhe në mandatin e kalum kanë qenë 3 komitete, Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komiteti për Arsim, Kulturë, Rinië dhe Sport, si dhe Komiteti për Ambient, Urbanizëm dhe Shërbime Publike.

znj.Arbresha Sylja: Krijimi i këtyre Komiteteve shtesë për Kuvendin sigurisht që do t'i ndihmojnë Kuvendit, po njëkohësisht edhe ekzekutivit në punën edhe aktivitetin e përditshëm. E përkrahu edhe propozimin që të jenë sa më shumë të përfshirë anëtarët e Kuvendit. Ju kisha inkuraj që me gjet forma që me pas kompensim.

z.Grejtalb Emini: Sa i përket Komiteteve tjera, a qëndrojnë ato Komitete që kanë qenë më herët në mandatin e kalum? Sa i përket këtyre, mendoj që me këta tre përfshihen gjitha anëtarët e Kuvendit, dhe nuk kena nevojë me përfshi dikënd tjetër.

znj. Erza Salija: Unë jam për formimin e këtyre komiteteve, qofshin me pagesë apo pa pagesë.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Pra po e propozojë themelimin e tri komiteteve tjera me këto emërtime, nëse keni edhe emërtime ose propozime për emërtim, nuk është problem, atëherë Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komiteti për Arsim, Kultur, Rini dhe Sport dhe tre Komiteti për Ambient, Urbanizëm dhe Shërbime Publike.

z.Grejtalb Emini: Unë i potencova edhe më herët. I kemi tri komitete jo të përhershme. Njëri nga këta do të jetë me pesë anëtarë. Dy nga këto Komunitet duhet me qenë me tre. Nuk kena nevojë me marrë shoqëri civile ose naj biznes kur është funksional.

z.Demokrat Mujota: Unë konsideroj që duhet të jetë çelësi pesë anëtarë për secilin Komitet. E dimë që s'ka anëtar të Kuvendit më shumë për me futur, po mundemi me marrë ekspertë nga jashtë Kuvendit që na ndihmojnë dhe i kontribujnë punës shumë ma të mirë për Kuvendin e Komunës së Shtimes.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Sa i përket komiteteve jo obligative, ne buxhetin e kena aprovu në muajin shkurt, që mbas Qarkorës së dytë Buxhetore i ka pas të përcaktuara të gjithë kufijtë buxhetorë edhe ne mundësi financiare për me pagu komitete që janë jo obligative e sidomos anëtarë që janë jashtë Kuvendit. Për shkakë se ne nuk mundemi me rreziku buxhetin e pagave që me metë dikush prej stafit që janë pa paga. Kështu që ju sugjeroj që brenda asambles me qenë gjithë anëtarët, për shkak se anëtarët jashtëm ne nuk kemi mundsi me i pagu.

z.Muhamet Ademaj: Unë kam këtu nënin 14 përbërja dhe organizimi i komiteteve të tjera, ku thotë se Komitetet e tjera të caktuar themelohen nga Kuvendi i Komunës në fusha të caktuar përbëhen nga anëtarë e Kuvendit dhe përfaqësues jashta Kuvendit të Komunës që janë ekspertë të fushave përkatëse. Edhe te neni 14.1 anëtarët e Kuvendit nuk kanë të drejtë të jenë më shumë se në një Komitet.

z.Besnik Seferi: Atëhere fillimisht unë e prapë po duhet të më ndal tek pjesa që e thashë qysh në fillim, që të gjitha këto Komitete duhet të shtyhen. Mbi afër 60% e buxhetit e keni për paga. Mua personalisht po më duket absurditet, për çka unë kërkojë edhe nga grupi jem parlamentar i LVV-së por edhe nga ju këshilltarë nga LDK dhe nga PDK, të formohen Komitetet me çelsin 5,3,3.

znj.Arbesha Sylja: Për çka po kërkojina prej jashtë ekspertë, a nuk janë ata qytetarë të Shtimes? Nuk jena këtu me bo folklorizma, me gjithë respektin për ty. Ka ekspertë që janë të kësaj Komune, që kontribujnë në këtë Komunë edhe që kanë të drejtë të kontribojnë në kuptimin profesional, me u shpërblyer se nuk janë parat e tua ato, po janë parat e taksa paguesve. Kanë të drejtë ligjore barabarë me të gjithë ne të tjerët. Nuk mundesh ti një njeri, nëse u ofron dikush punë profesionale, me ardhë këtu dhe me thënë, po lypin pare. Me pare, pa pare kena punu këtu krejt, nuk ka punu veç grupi juaj.

z.Besnik Seferi: E nderuame kolege, paraprakisht, me gjithë respektin që kam edhe unë për juve, unë nuk i bi kundër asaj se çka tash. Prapë qëndroj në ato që kjo është zhvatje e buxhetit të komunës së Shtimës. Pse është zhvatje? Sepse po krijojmë mundësi për punësim, për njerëzit që me ja realizu disa appetite dikujt e dikujt. Prandaj unë mendoj dhe prapë qëndroj mbas asaj. Në ato Komitete aty nuk lypet ekspertizë.

z.Atdhe Isufi: Ne nuk kena propozu me zhvat shtetin as me keqpërdorë. Nëse dojna, mu bë djem të mirë krejt edhe me kontribu, a jeni pro krejt Komitetet i bëjina pa pagesë. Pse një komitet duhet mu pagu, ndërsa ni tjetër nuk duhet të mu pagu? Po ankoheni që 60% e buxhetit shkon për paga, ne nuk i kemi punësu ata. Nëse ti thu që këto Komitete nuk kan rëndësi, mos i bëni fare këto Komitetet. Nëse ju mendoni që ato komisione janë bë sa për sy e faqe sa për me i marrë ato meditje, anuloni komplet komisionet. Nuk është këtu, disa po i bëjina disa nuk po i bëjina.

z.Besnik Seferi: E di që keni mi votu se i kini votat. Unë thashë që nuk është nevoja që me marrë njerëz prej jashtë me sjellë në këto Komitete, duke qenë ne këtu, pika e parë dhe secili anëtar i Kuvendit Komunal është i përfshirë nëpër këto Komitete që ka me mujt me e jap kontribut të jashtëzakonshëm.

znj.Arbresha Sylja: Mandatin e kalum vet kam qenë anëtare si eksperte e jashtme. në një Komitet edhe kena mujt me shërby shumë edhe me dhënë shumë ide të mira, por nuk e keni funksionalizu më atë Komitet,ne nuk e dimë se çka ndodhë. Nuk ka lidhje pagesa, as kurrë nuk kemi kërkuar pagesë. Nuk munesh mi quajhtë zhvatës, as neve, as ata njerëz që na kërkojnë me u angazhu këtu se është një terminologji e keqe e fjalëve që jeni msu kështu me ju vendos hijë syve të qytetarëve.

znj.Albana Podvorica-Hoxha: Besnik sigurisht nuk je në dijeni që Komitetet që kanë qenë funksionale mandatin e shkuar kanë pasë nga një ekspert të jashtëm. Kështu që nuk besoj që ka ndonjë problem edhe pse kanë qenë pa pagesë, si ka qenë puna e tyre flasin procesverbalet vetë.

znj.Yllkë Fejzullahu: Koleg-ja parafolëse për Besnikun e keqinterpretoj fjalën edhe e tha sikur Besniku po i quan zhvatës personat nga jashtë, ekspertët që po dojnë me hyjë në këtë Komitet, që nuk është aspak e vërtetë. Ne si LVV nuk jemi duke i quajtur zhvatës ekspertat. Zhvatës nuk janë ata, zhvatës jeni ju sepse kaq keni mundësi. dhe ndoshta ju keni premtuar me ju dhënë pagesë simbolike, zhvatja vjen nga ana e juaj. Sinqerisht MAPL-ja kur ti sheh materialet që kane me i shku nga kjo mbledhje, ka me qesh me neve. Edhe në këtë rast, drejtori Besnik Ahmeti e shtjelloi shumë mirë, po thotë shumë qartë, nuk ka buxhet për me i pagu.

z.Muhamet Ademaj: Kryesisht ne jemi dëshmitar se kemi qenë bashkë me një Komitet. Drejtori tha që nuk ka mjete. Kështu që është mirë ta kuptojmë njëri-tjetrin. Pastaj vitin e ardhshëm.e planifikojmë që edhe komitetet jo obligative me i futë në buxhet.

z.Haqif Arifi: Shumë drejtë kolegu Muhamet, e lexoj ligjin që ka drejtë mu formuar Komitetet edhe jashta saj edhe me u paguar. Kërkesa për formimin e Komisionit ka qenë pikërisht e propozuar nga grupi parlamentar i LDK-së domethënë edhe është miratuar. E për këta se si i kanë shfryzuar parat më së mirti tash ka me treguar raporti vjetor buxhetor, po edhe raporti periodik i auditimit e ta shohim se si i kanë ruajtur parat.

z.Demokrat Mujota: Pushtetet janë të ndame, pushteti legjislativ edhe ekzekutiv. Pushteti legjislativ, që jemi ne që i përcaktojmë me vota numrat, komitetet, komisionet, krejt ato. Pushteti ekzekutiv e ka detyrë edhe obligim me i mbajt me të hyrat vetanake. Kështu që mos të mirremi këtu me kësi gjëra. Ju keni marrë njerëz që janë të akuzum për krime lufte në Kosovë, prej Fushë Kosovës, egjiptian, çka janë kon ata? Keni sjellë drejtor prej Kaçanikut.

z.Grejtalb Emini: Unë mendoj që është deviju debati, ne jemi duke folur sot për çelësin e komiteteve. Nuk jemi duke fol a duhet mu paguar apo nuk duhet me u paguar. Besoj që ky Kuvend ka marrë një vendim mbledhjen e kalume e respektoi vendimin, kam votuar kundër me arsyetimin se Drejtori i Financave shumë qartë e ka spejguar që nuk ka buxhet., por respektoj vendimin e Kuvendit.

z.Atdhe Isufi: Unë deshtë ta bëjë një pyetje Drejtorit të Financave, sa ekspertë ka punësuar vitin e kaluar Komuna nëpër dikasteret e vet? Çfarë kualifikimi kanë dhe si janë të emëruar si ekspertë edhe sa ka harxhu Komuna pagesa për ata ekspertë.

znj.Fatlinda Rrafshi: Pyetja e duhur kishte me qenë, sa paguhen jashta orarit të punës më konkretisht.

z.Faik Ramadani: Ditën e parë kam thënë që unë ka me fol në emrin tim, pa u konsultuar me askënd nëse shohë që po dëmtohet buxheti i Komunës. Nuk jena ardh këtu na me zhvatë buxhetin e Komunës së Shtimes. Edhe kjo fjalë ke tepër tepër e rënd, me ju drejtuar dy grupeve parlamentare. Ende nuk është vendosur për pagesa.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Sa i përket mbledhjes së kaluar, është e vërtetë që kemi marrë një vendim për pagesën e Komiteteve. Ju tregova që ai vendim gjendet për shqyrtim ligjor në Ministrinë e Financave. Ne sot jemi duke marrë vendim për formimin e këtyre Komiteteve. S'jemi duke kërkuar emra, s'jemi duke kërkuar ekspertë.

z.Besnik Seferi: Ti Kryesus shumë mirë e the këtë pjesën edhe e potencove shumë mirë pjesën se çka në fakt janë këta trupa që janë trupa ndihmës të këtij kuvendi e para. E dyta u potencua që unë e përmenda këtë termin zhvatës nëse ju si të tillë e merrni që ju jeni zhvatës atëherë më falni thotë një fjalë e urtë e popullit, e bajshi me shëndet.

z.Atdhe Isufi: Unë po foli personalisht për veti, hera e parë që kam marrë rrogë prej këtij shteti, është po prej këtij Kuvendit Komunal. Nëse mua ti mundesh me më thënë zhvatës, mi jep arsytet që e kam zhvat, çka kam zhvatë deri sot.

znj.Arbresha Sylja: Ato termat ishn për neve, për propozimet e tona, se këtu dikush tjetër nuk e ke. Ne në pozita publike kemi qenë një kohë. Asnjëherë nuk e kena keqpërdor as një cent të këtij shteti, as të kësaj Komune në veçanti. Terminologjia ke krejt gabime e shprehur. Pyetja për këta ka qenë pse mandatin e kalum, kanë leju këta me pas ekspertat të jashtëm, këtë mandat pse nuk po dëshirojnë të kenë ekspertat të jashtëm?

Nënkryetar, z.Adnan Ademi: Përshëndetje. Kryesuesi e tha qartë, nëse e keni dëgju me vemendjen në fillim, po jeni duke e keqpërdor edhe Kryesusin në këtë rast. E tha që ne po themelojm, tri komitete. As nuk kërkoj emra, as mbiemra. Po munohuna që sinjerisht me zbutë situaten, mos me përdorë kësi terma në Kuvend se nuk ju ka hije, se e dini gjithë që jemi live këtu, dhe po na shohin gjith qytetarët e Shtimes. Shkojna me formulën pesë tre tre edhe përfshihet komplet Kuvendi në komitetet e tjera. Mos harroni, ju munda me votu çka doni këtu. Unë jam i bindur që sot kjo seancë po më vjen keq me thënë po gjysma ka me shku poshtë nga MAPL-ja .Votoni ashtu siç thotë rregullorja e Kuvendit Mos mendoni me përdor arrogancën e votës, sepse është MAPL-ja që na mbikëqyrë.Më shumë e pata kryesisht fjalimin në formë të këshillimit sesa me bë atë debatin politik. Gjuhën ju kisha lutë me ru se nuk është e arsyeshme as në rregull me ofendu njëri - tjetrin. Sot jemi në Kuvend, nesër mund të mos jemi.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Së pari duhet me u planifikuar në buxhet. Nëse nuk planifikohet në buxhet, ne bëjmë shkelje të ligjit. Domethënë për me u ekzekutuar këto, duhet të jenë të planifikuara në buxhet. Nuk ka pas mëditje për komitetet obligative asnjëherë. U përmenden edhe disa punonjës shtesë, unë një sen po e themë nuk ka asnjë zyrtar qe osht ne listen e pagave, që merrë pagë e nuk vjen në punë. Sikur ka ndodhë më heret qe ka qenë në listen e pagave, dhe nuk ka ardhë në punë. Po shihet që janë bashku forcat për me i realizuar disa premtimet qe u kan premtuar disa dostave te vet.

z.Demokrat Mujota: Kryetari i Komunës ka dy shofera. Ketu është një djal që është shofer i Adnan Ademit edhe i njeiti e merrë rrogen tjetër si praktikant. Po po ti e ki djalin e Demes të Godancit, si shofer. E tjetri e keni Idajet Rexhepin njeri që ka dalë në pension edhe prapë merrë rrogë si ekspert. Pse Kuvendi nuk paska drejtë me pas ekspertë? Nëse Demokrat Mujota ose një familjar i imi e ka bë një zhvatje të shtetit ose njëherë ka vjedh prej shtetit, kurrë në jetë më me politikë nuk mirrna.

Nënkryetar, z.Adnan Ademi: Nuk kam replikë po kam një ndërhyrje, ti prej sot merri edhe hulumtoj krejt dokumentet. Jap zotim publik para mediave nëse Adnan Ademi ka pas shofer edhe veturë te Komunës personale, sot zotohem para gjithë qytetarëve qe kurë më me politik nuk mirrem. Kjo është shpifje sepse unë nuk kam shofer.

znj.Yllkë Fejzullahu: Kjo është zhvatje more, personat që dëshironi me i punësu si ekspertë doni me i rahatu. Nuk është në rregull Demokrat Mujota i përmendni me emra me shofera, por ju PDK-ja keni punësuar njerz që nuk kanë ardhur hiç në punë.

Nënkryetar, z.Adnan Ademi: I kërkoj z.Mujotës që të jep zotim publik, në qofëse këtë që e tha nuk është e vërtetë të jep dorëheqje nga Kuvendi. Kështu që prej sot ju bëjë me dije gjithë qytetarëve që z.Demokrat Mujota do të paditet për këtë shpifje që e ka bë në drejtim tim.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Çelsi i këtyre Komiteteve do të jetë 5 për secilin Komitet. Nëse nuk kalon ky propozim, do e hedhë në votim propozimin që çelsi të jetë 3,3,5.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 12 vota "Për", 8 vota "Kundër" dhe 1 votë "Abstenim" miratoi Vendimin për formimin e 3 (tri) Komiteteve tjera, në përbërjen e të cilëve do të ketë nga 5 (pesë) anëtarë për secilin Komitet si vijon:**

1. Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport,
2. Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,
3. Komiteti për Ambient, Shërbime Publike dhe Urbanizëm.

Pika 6

Themelimi i Komisionit të Aksionarëve për KRM "Pastërtia" SH.A., Njësia në Shtime

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Fjalën ja dha z.Grejtalb Emini.

z.Grejtalb Emini: Sa i përket themelimit të Komisionit, paraprakisht menoj që do të ishte e rrugës që të kemi një raport nga Komisioni i mëhershëm KRM "Pastërtia", prandaj propozojë që kjo pikë të shtyhet pasi që nuk kemi një raport të tillë.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Faleminderit Grejtalb. Kjo nuk e ndalon themelimin e Komisionit. Është e vërtetë që mundemi me bë kërkesë me kërku informacione prej komisionit të kalum, ata mundemi me bë në mbledhjen e radhës.

z.Muhamet Ademaj: Unë mendoj që këtu si anëtarë duhet të jetë 1 nga opozita, 1 duhet të jetë nga pozita, si dhe një i propozuar nga ekzekutivi.

z.Shefqet Krasniqi: Sa i përket pikës, ne si LDK nuk kemi diskutime, po kemi dy propozime dhe nëse mund të vazhdojmë me propozime. Ne propozojmë znj.Albana Fazliu dhe znj.Rrezarta Ramadani.

znj.Yllkë Fejzullahu: Pavarësisht që PDK-së po i dhemb, edhe kjo pikë e tregon shumë qartë se po ju djeg fjala zhvatje. Kaq pak pushtet keni edhe çfarë keqpërdorimi bëni. Kjo tregon shumë për qeverisjen e PDK-së edhe në të kalumën. Unë e thashë edhe më herët edhe kjo pikë është ndër pikat që nuk është konsultuar fare Kryetari i Komunës.

Kur ka gjuhë të papërshtatshmë si Demokrat Mujota që e përmendi më herët fjalën vjedhës, do të ishte mirë me pas një reagim nga ana e juaj Kryesues.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Po e hedhim në votim propozimin që të shtyhet kjo pikë.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 9 vota "Për" me 12 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim" nuk e miratoi propozimin për shtyrjen e pikës "Themelimi i Komisionit të Aksionarëve për KRM "Pastërtia" SH.A., Njësia në Shtime".**

z.Besnik Seferi: Atëherë propozimi ynë si subjekt politik do të ishte për mu shty kjo pikë, po nuk kishim vota. Andaj si të tillë ne nuk jemi për me insistu që mos me vazhdu tutje. Edhe ne kemi një propozim, dhe propozimi ynë është që në këtë Komision të KRM "Pasertia" të jetë i përfshirë z.Fadil Ismajli.

z.Demokrat Mujota: Unë Fadil Ismajlin e kam shok të shpirtit, jam rritë me të edhe LVV-ja e ka propozuar me qëllim që të më testoj. Po unë e votoj Fadil Ismajlin me gjithë shpirt, se jam rritur me to.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Atëherë po e hedhë në votim propozimin që Fadil Ismajli me qenë anëtarë i KRM "Pastërtia".

***Kuvendi i Komunës së Shtimes me 10 vota "Për" 11 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim" nuk e miratoi propozimin që z.Fadil Ismajli të jetë anëtarë i KRM "Pastërtia" SH.A., Njësia në Shtime.**

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Meqenëse propozimi i LVV-së nuk kalojë vazhdojmë me propozimin e LDK-së. Po e hedhë në votim.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes me 12 vota "Për" 0 vota "Kundër" dhe me 9 vota "Abstenim" miratoi Vendimin për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM "Pastërtia" SH.A - Njësia në Shtime, me këtë përbërje:**

1. z.Faruk Beqa (i emëruar nga Kryetari i Komunës),
2. znj.Albana Fazliu (e zgjedhur nga Kuvendi),
3. znj.Rrezarta Ramadani (e zgjedhur nga Kuvendi).

Pika 7

Themelimi i Komisionit të Aksionarëve për NPL "Ekosistemi" SH.A. – Shtime

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Ky Komision ka ekzistuar në mandatin e kalum. E njëjta qëndron edhe këtu një anëtar caktohet nga Kryetari dhe dy anëtarë nga Kuvendi. Hapë diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi: E potencoi shumë mirë edhe Drejtoria e Financave tha që buxhet kjo Kompani nuk ka, për çka është e pamundur të bëhet realizimi. Përkundrazi, nuk kemi ndonjë propozim,

për faktin që derisa nuk kemi propozim, kjo do të thotë që ne nuk jemi për me dërgu emër pa pas kurrfar buxheti ajo Kompani.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Tha që nuk keni propozime, Besnik Seferi e ka fjalën përsëri.

z.Besnik Seferi: Unë kisha propozuar prapë që të jetë në këtë komision Fadil Ismajli.

znj.Arbresha Sylja: Nga PDK-ja propozojmë z.Bajram Hajrizi.

znj.Frosina Berisha- Ahmeti: Nga LDK-ja propozoj z.Atdhe Isufi.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Po i hedhë në votim propozimet e juaja.

Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 12 vota “Për” 7 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstënim” miratoi Vendimin për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërrmarrjen Publike Lokale “Ekosistemi” SH.A. – Shtime, me këtë përbërje:

1.z. Fadil Ismajli (i emëruar nga Kryetari i Komunës),

2.z. Atdhe Isufi (i zgjedhur nga Kuvendi),

3.z. Bajram Hajrizi (i zgjedhur nga Kuvendi).

Pika 8

Informatë për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2025

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Fjalën ja dha Nënkrëtarit, z.Adnan Ademi.

Nënkrëtar, z.Adnan Ademi: KKSBJ-ja është një prej komisioneve më të rëndësishme në komunën e Shtimes, i cili bën një punë të jashtëzakonshme. Këtu janë të përfshirë gjitha institucionet lokale, këtë këshill e ka kryesuar kolegu Faruk Beqa, që në atë kohë ka qenë Nënkrëtar i Komunës. Dhe po besoj që raportin e keni marrë me kohë dhe e keni lexuar gjithë. Te kjo informatë, duhet me ditë që në shumicën e rasteve ka çështje konfidenciale që nuk thuhën publikisht, ky këshill i ka mbajtur të gjitha mbledhjet me rregull, ka dhënë sygjëime dhe ka marrë vendime që kanë pasur të bojnë me Zyrën e Kryetarit, ekzekutivin dhe gjitha institucionet. Megjithatë unë nuk kam qenë pjesë e këtij komisioni, po në emër të Kryetarit sot më duhet të dhë këtë informatë shkurt.

znj.Arbresha Sylja: Realisht, për punën që e bën si këshillë edhe çdo herë si ka vepru, ka qenë në rregull dhe i shërben sigurisht komunitetit. Vetëm është një pyetje teknike, këtu figuron z.Lulzim Sahiti drejtor i arsimit, a është drejtor apo ka mbetur gabimesh aty?

z.Haqif Arifi: Unë e kam lexu informatën. Është shumë e vërtetë që janë mbajtur mbledhjet, 6 mbledhje të rregulla dhe 2 të jashtëzakonshme. Sa ka qenë aktiv ky këshill, a ka pasur diskutime nga të gjithë anëtarët sepse përpos Nënkrëtarit të atëhershëm edhe Komandantit të policisë, nuk e pash që ka diskutuar dikush tjetër? Edhe a janë zbatuar të gjitha masat që janë marrë?

Nënkrëtar, z.Adnan Ademi: Unë e thashë që në fillim, që këshilli ka bërë një punë të jashtëzakonshme. Po gjitha ato rekomandime që kanë dalë prej këtij këshilli, unë besoj fuqishëm që janë realizu edhe përmes stacionit policor, po edhe përmes Qendrës për Punë Sociale. Besoj që në Komunën e Shtimes gjendja është shumë stabile. Na din që çdo Komunë mundet me pas probleme ndryshe, po të gjitha problemet janë trajtu një nga një.

z.Faruk Beqa: Praktikisht ashtu siç u tha, janë mbajtur 6 mbledhje të rregulla, 2 të jashtëzakonshme. Unë ju themë me plot përgjegjësi se nuk ka asnjë anëtar që aty nuk ka diskutuar në secilin takim. Domethënë, rekomandimet që kanë dalë nga aty janë përcjell te zbatuesit, te Qendra për Punë Sociale, te zjarrfiksat, te policia. Konsiderojmë se kemi kry punën me nder.

z.Haqif Arifi: Thash me qenë se s'kemi pas raporte, vetëm një format nuk u përmend askush, përpos Nënkrëtarit të atëhershëm edhe Komandantit të policisë. Edhe për ata e shtova pyetjen a ka pasur sukses, masat që janë marrë me siguri edhe janë zbatu. Kjo ishte me ditë se si informatë ka qenë shumë e shkurtë edhe nuk kemi pas njohuri më tepër.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Nëse nuk ka diskutime tjera, konsideroj të mbyllur këtë pikë, dhe nuk votohet kjo pikë pasi që është informatë.

Propozim - Vendim për themelimin e Këshillit Komunal për Sigurinë në Bashkësi – KKSB

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Duhet që të lexoj një nga një secilin emër të pjesëmarrësve, juve ju mbetet që vetëm ta votoni këtë përbërjen. Emri i përfaqësuesit nga OJQ z.Besnik Brahimi është ndryshuar, për shkakë që shoqëria civile ka mbajtur një mbledhje dhe e ka sjellë emrin e Lirim Halimit nga Kryqi i Kuq. Unë ju ksha lutur që mos të zgjatemi shumë. Gjithsecili është i fushës dhe janë të konfirmuar nga secili institucion.

znj.Fatlinda Rrafshi: Unë e propozoj që z.Muhadin Halili të jetë po ashtu anëtarë, pasi është në ekipen vepruese për siguri në bashkësi. Njëkohësisht edhe propozojë z.Besnik Shalen të jetë në zëvendësim të z.Lulzim Sahitit.

z.Demokrat Mujota: Që 6 orë asambleistat e LVV-së na kanë akuzuar, ty personalisht Kryesues edhe neve që nuk kena kontakt me Kryetarin e Komunës për pikat e rendit të dites. Pas 6 ore, del Nënkryetari i Komunës edhe e vërtetoi që po ka pasur dakordim për pikat e rendit dites.

znj.Yllkë Fejzullahu: Domethënë, si në 7 pikat e kalume, ashtu edhe në këtë pikë po tentohet prapë me fut njerëz të afërm nga pushteti i kalum. Unë kam punu edhe me z.Lulzim Sahitin edhe me z.Besnik Shalen për të dytë kam respekt. Është absurde me kërkë që Udhëheqësi i sektorit për arsim mu largu prej këtij këshilli, edhe me vendos një zyrtar të arsimit, siç është z.Besnik Shala. Domethënë, me shku tek personi i tretë, ndoshta sipas rëndësisë në arsim, e me anashkalu udhëheqesin e sektorit për arsim. Aq më pak tu e ditë përvojën që e ka z.Lulzim Sahiti.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Në udhëzimin administrativ thotë drejtori i arsimit, kështu që as shefi i sektorit e as zyrtari nuk ka nevojë me qenë hiç në këtë këshillë, po kur zgjidhet drejtori i arsimit vjen emri. Kështu që nuk ka asgjë absurde. Propozime për anëtarët e Kuvendit mundem me bë.

Nënkryetar, z.Adnan Ademi: z.Muhadin Halili nuk mundet me qenë pjesë e këshillit fare, sepse është pjesë e prokurimit dhe është udhëheqësi i prokurimit, këtë e thotë ligji. Çështja tjetër është që Lulzimi, ato që Yllka i tha qëndrojnë përderisa s'ka drejtor është edhe ushtrus detyre i drejtorit. Dhe nuk mundet një zyrtar me dal para ushtrusit të detyres. Kështu që mos të bëjmë gabime se na u kthehen gjitha vendimet prej MAPL-së.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Në vazhdim e lexoi U.A. lidhur me përbërjen e këshillit, z.Lulzim Sahiti është vetëm udhëheqës i arsimit.

z.Grejtalb Emimi: Këtë propozim e ka bërë Kryetari i Komunës. Tash po bëjka U.A për KKSB-në, më herët nuk bëri për KPF-në. Aty shkonë Drejtori i arsimit, nëse ka ushtrues detyrë vjen nëse s'ka, ka përgjegjës, ka hierarki. Nuk merret një zyrtar me dal përpara përgjegjësit.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Neve na ka ardhë një propozim-vendim. Me pas qenë total e varur nga Kryetari i Komunës, si ekzekutiv ai e kish nënshkruar, vulosur edhe kjo çështje do të mbaronte. Anëtarët e Kuvendit kanë drejt me bë përmirësime. U përmend z.Lulzim Sahiti si drejtor i arsimit, ose ushtrues detyre ma sjellni ju mua edhe ne e vendosmi. E dyta z.Muhadin Halili është zyrtar në zyrën e prokurimit, është përgjegjës realisht mirëpo në njëjtën kohë jashtë funksionit të tij zyrtar ai kryen detyrat e kryesisë për siguri në bashkësi, nuk është konflikt interesi. Pjesën e Drejtorit të arsimit e lëmë të zbrazët.

z.Haqif Arifi: Ju lutem, nëse është ushtres i detyrës, nuk kemi çka me diskutu, ai shkon automatikisht.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Po e hedhë në votim propozim- vendimin me ato propozime që u bënë, aty ku shënon Drejtori i Arsimit mbetet zbrazët. Në momentin që emërtohet Drejtori i Arsimit le t'a sjellin Kuvend dhe e zavendësojmë.

z.Faruk Beqa: z.Muhadin Halili ka qenë edhe në mandatin e kaluar. Unë konsideroj që personat që vinë duhet të kenë legjitimitet.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Pasi që diskutime tjera nuk ka po e hedhë në votim këtë propozim-vendim.

***Kuvendi i Komunës së Shtime unanimisht miratoi Vendimin për zgjedhjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Shtimes, në përbërjen si vijon:**

1. Qemajl AliuKryetar i Komunës,

2. Haxhi BehluliKomandant i Policisë – Shtime,
3. Vedat ShatriPërfaqësues nga Forca e Sigurisë së Kosovës,
4. Skender BaftiuKryetar i KBI, dhe Imam i Xhamisë - Shtime,
5. Skender DautiUdhëheqës i Sektorit për Emergjencë,
6. Muhamet MehmetiZyrtar për të Drejtat e Komuniteteve,
7.Drejtor i Drejtorisë Komunale për Arsim,
8. Reshat GashiKordinator për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore,
9.Kryesuesi i Komitetit për Komunitete,
10. Sabrije VeluPërfaqësues i Komitetit Ashkalinjë,
11. Arton DemiriPërfaqësues i Komitetit Rom,
12. Khavit BunguPërfaqësues i Prindërve në shkollat e komunës së Shtimes,
13. Lirim HalimiPërfaqësues i OJQ,
14. Muhadin HaliliPërfaqësues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi.

Pika 10

Raporti Vjetor Buxhetor Janar - Dhjetor 2025

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Fjalën ja dha z.Besnik Ahmeti.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Buxheti i komunës së Shtimës për vitin 2025, ka qenë i aprovuar prej 10.777,180 milion euro. Në tabelë gjatë muajve janar edhe muajve korrik, ky buxhet në vijim ndryshon. Në vazhdim lexoi materialin si në vijim (shih dokumentin).

z.Muhamet Ademaj: E falenderoj z.Ahmeti për prezantimin e raportit. Raporti është përgatitur mirë. I cili përmban shpenzimet e buxhetit dhe të hyrat vetanake. Buxheti është shpenzuar 98.26%, sipas raportit të Drejtorit. Sipas informatave që i kemi, disa projekte nuk janë realizuar gjatë vitit 2025 për shkakë të marrjes së parave nga përmbarusi. Kështu që është një projekt te unë që ka pasur të realizohet te rruga “Hyre Emini”, ndërtimi i trotuarit. Mirëpo, sipas informatave që kemi nga Drejtoria, ky projekt nuk ka mund të realizohet për shkakë të marrjes së parave nga përmbarusi. Pyetja për ju Drejtor, sa është shuma e mjeteve që i mori përmbarusi gjatë vitit 2025?

znj.Fatlinda Rrafshi: Raporti aktual paraqet vetëm përqindjen e realizimit dhe jo detajet dhe kodet ekonomike. Pa këtë ndarje është e vështirë të bëhet një vlerësim real i menaxhimit të buxhetit. Prandaj kërkoj që në raportin e radhës të jenë të cekura të gjitha kodet ekonomike edhe shumat përkatëse të cilat janë të ndara këtu. Unë e kërkoj të kem listën e plotë të projekteve të cilat janë realizuar. A ka pasur vonesa apo rritje të kostove edhe sa nga këto projekte janë investime të reja dhe sa kanë qenë vazhdimësi nga vitet e kaluara? Gjithashtu edhe në administratën e përgjithshme shihet se ka pasur shpenzime, dëshiroj të di ku janë shpenzuar?

z.Besnik Seferi: Nga ajo që u paraqit në raport, shihet se ka pasur përpjekje sigurisht për të ruajtur një stabilitet financiar dhe për të realizuar projektet e planifikuara për qytetarët, sigurisht. Natyrisht si çdo buxhet, ka sfidat, po ashtu ka edhe vonesat por të cilat drejtorit përkatëse janë munduar që të menaxhojnë në mënyrën më të mirë të mundshme. Prandaj si grup parlamentar ne do të jemi “Për” këtë raport.

z.Haqif Arifi: Unë veç isha nal shumë shkurtimisht, sepse nuk e bëri një krahasim mes periodes së 3 dhe të 4. Krahasimi në raport Janar-Shtator jep një paqyrë të qartë mbi dinamikën reale të menaxhimit të buxhetit gjatë vitit 2025. Kjo do të thotë se një pjesë e konsiderueshme e shpenzimeve është koncentruar në tremujorin e fundit. Sipas parimeve të Menaxhimit të Financave Publike, buxheti duhet të realizohet në mënyrë proporcionale gjatë gjithë vitit, jo të përqendrohet në fundvitë. A ka pasur vonesa në planifikim? Sa obligime janë bartur prej vitit pasues?

znj.Yllkë Fejzullahu: Fillimisht e falënderoj drejtorin për këtë informatë kaq të detajuar, po ashtu edhe gjithë zyrtarët e Financave që kanë punuar në këtë material kaq voluminaz. Unë sinjerisht më vjen mirë që po e shoh një përqindje kaq të lartë të buxhetit të shpenzuar. Dhe natyrisht që kjo është pasuar me qindra projekte. Është për keqardhje dëmet që i shkakton kontrata kolektive, e cila është votuar më herët nga ministrat paraprakë me papërgjegjësi totale

realisht, sepse kanë votuar një kontratë pa e pas bazën financiare. Edhe tash e sa vite ju paraqet jashtëzakonisht shumë problem Komunave.

z.Demokrat Mujota: E kam një pyetje për çështjen e përmbaruesit privat, prej se është marrë pushteti prej LVV-së gjithmonë është akuzuar pushteti i kaluar për borgjet e të kalumës. A mundemi me ditë saktë, edhe sa borgje ka Komuna e Shtimes, që rrezikon me i marrë përmbaruesin privat? Pse janë borgjet e mbetura edhe si pretendohet me ja pagu ato borgje përmbaruesit privat?

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Kisha kërku prej juve meqë i kemi dy raporte, njëra është 9 mujor edhe tjetri vjetor, me shku në pako të votimit të tyre nëse është e mundur, që me e shkurtu si procedurë.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Sa i përket pagesa për vendime gjyqësore as unë as askush nuk mundem me ditë saktë sa janë obligimet sot. Sa i përket formës së raportit, u diskutu që raporti nuk është forma e mirë, kështu që unë e po ju themë ata që kanë punu me financa e din që ky raport nuk bëhet prej Drejtorit të Financave, as prej zyrës së financave, ky është raport që e gjeneron sistemi. Nuk mundet me e ndryshu as unë as askush. Pajtohem që keni te drejtë me kërku gjitha shpenzimet nëpër gjitha linjat, ku janë shpenzuar, mirëpo ato shihen te pasqyrat financiare, aty shprehet çdo detaj. Planifikimi i shpenzimeve bëhet nga të gjitha drejtoritë pastaj dorëzohet te Drejtoria e Financave. Sa i përket pyetjes, a ka pasur vonesa në pagesa? Po ka pasur, se kontrata kolektive, na i ka prishë projektet, edhe është dashtë me bë korrigjime, që ku kena pas mundësi që ato projekte që janë kanë më vitale, me i rikthi edhe me i thënë kontratës kolektive merri këtu parat.

z.Demokrat Mujota: A mundesh me ma spjegu momentin kur të mirret një vendim i një gjykate, që obligon Komunën për me bo pagesë mbi ni çështje të caktume. Nëse vonohet ajo çështje e caktume që nuk e bënë pagesën Komuna, ajo kalon te përmbaruesi apo? Nëse do e kishte bë në raundin e parë Komuna atë pagesë, a është shuma e pagesë më e madhe për Komunën në raundin e parë, a nëse kish kalu te përmbarues privat?

z.Muhamet Ademaj: Shumë para thatë që janë marrë nga kontrata kolektive, që është nënshkruar nga ish-qeveria edhe a parashihet që këto borgje me i paguar Ministria e Financave?

z.Besnik Ahmeti, DBF: Nuk ka zyrtare diçka që ka mbaruar çështja. Nëse lënda ka shkuar për një kontratë kolektive, po supozojna ne nuk kemi drejtë me ekzekutu për shkakë se duhet me ekzekutuar prej pagave. Prej pagave nuk mundemi me ekzekutuar. Nuk mundesh me ekzekutuar kontratën kolektive prej mallrave ose shërbimeve, ose prej ni kategorie tjetër. Nuk të pyet gjykata ti merr, ti s'ke drejt me ekzekutu, po ai ti merrë.

z.Demokrat Mujota: Pse Komuna e Shtimes nuk e bënë pagesën në raundin e parë, se na ka mbetë në dorë të përmbaruesit Komuna?

Nënkryetar, z.Adnan Ademi: Kontrata kolektive nuk është nënshkruar vetëm për Komunën e Shtimes, por është nënshkruar nga niveli qendror. Dhe të gjitha Komunat, edhe pse ka qenë kontrata të jashtëligjshme, kanë fillu zbatimin e kontratës. Komuna e Shtimes ka fillu me e zbatu gjithë kontratën kolektive mas vitit 2021. Asnjëherë Komuna e Shtimes nuk ka bë pagesë prej vitit 2016 deri në vitin 2022. Edhe kësioj janë mbledhë gjitha landë edhe kanë shku nëpër gjykata edhe tash po vin prej përmbaruesve. Dhe këtu tash nuk mundet askush me definu saktë se sa është vlëra. Nuk po du me ja hudhë fajin askujt, po kjo kontratë është dashtë atëhere kur ka marrë vendim Qeveria me filluar pagesën që në vitin 2016. Ka shumë prona në të kalumen që janë në procedura në gjykata. Janë asfaltuar rrugë nëpër ara ku ta dij unë edhe nuk janë shpronuar. Kjo është shumë e dëmshme për komunën e Shtimes.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Po i hedhë në votim të dyja raportet siç u dakorduam.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 13 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe 7 vota "Abstenim" miratoi Raportin Vjetor Buxhetor të Komunës së Shtimes për vitin 2025.**

Pika 11

Raporti 9 Mujor Buxhetor Janar - Shtator 2025

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Ky raport është votuar së bashku me raportin vjetor, që përafërsisht janë të njëjtë.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 13 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe 7 vota “Abstënim” miratoi Raportin 9 Mujor Buxhetor për periudhën Janar-Shtator të Komunës së Shtimes për vitin 2025.**

Pika 12

Raporti i Komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera për vitin 2025 dhe për muajin Janar 2026

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Fjalën ja dha znj.Albulena Emini.

znj.Albulenë Emini: Komisioni për Fatkeqësi Natyrore dhe Fatkeqësi të tjera, ka hartuar raporte, domethënë dy raporte. Raportin Janar-Dhjetor 2025 dhe raportin për muajin Janar të vitit 2026. Në kuadër të këtyre dy raporteve, Komisioni ka konstatuar për periudhën Janar-Dhjetor 2025, kanë qenë 56 kërkesa. Prej të cilave 44 kërkesa kanë qenë të aprovuara, 12 refuzuara. Natyra e kërkesave ka qenë, në ekonomi familjare, bujqësi dhe biznese. Nuk po i specifikoj vlerat sepse e keni raportin secili përpara, ndërsa për periudhën ose për muajin Janar të vitit 2026, Komisioni ka pranuar 70 kërkesa, në kuadër të secilave, 61 kërkesa janë të aprovuara, 9 kërkesa janë të refuzuara edhe këtu numri apo natyra e kërkesave ka qenë në ekonomi familjare, bujqësi dhe biznese. Realisht, si Komision jemi të obliguar që t'i hartojmë këto raporte dhe të aprovohet në Kuvendin Komunal dhe i njëjti të procesohet për Agjensionin e Menaxhimit Emergjent, në mënyrë që edhe ata të hartojnë raportin dhe të dorëzohet në Ministrinë e

z.Demokrat Mujota: Në momentin kur digjen shtëpitë si pasojë e erërave të fortë, a llogaritet kjo? A mirret për bazë që të konsiderohet si dëm?

z.Muhamet Ademaj: E falenderojë Komisionin që ka bërë një punë të mirë. E përkrahi miratimin e raportit përfundimtar të Komisionit për vlerësimin e dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore.

z.Atdhe Isufi: E kam shikuar raportin, dhe gjysa e dëmeve çka ju kanë shkaktuar, e di që nuk ka mundësi me ju kompenzuar 100% . Normalisht jam “Për” këtë raport.

z. Besnik Seferi: Atëherë, unë e kam një pyetje pronari i një firme apo kompanie, e cila njihet si “Paloma Diora SHPK”, para q viti e gjysmë vite pothuajse dy vite gati nuk gabona, e sigurisht edhe ju jeni njohuri për te, ka pas një djegie nga energji elektrike. Ka pasur dëme të mëdha. Aty është bërë një farë vlerësimi nga Komisioni, mirëpo Andaj deshta të di ku është ky si proces?

znj.Albulenë Emini: Komisioni në bazë të një rregullore që e kemi, dëmet të cilat shkaktohen prej zjarrit, realisht nëse zjarri nuk është fatkeqësi natyrore, po vije prej një fatkeqësie tjetër që në shumicën e rasteve, rastet e zjarreve që e kemi janë prej energjisë elektrike, këto raste nuk i trajton fare. Pra Komisioni nuk i fut në listen e përfituesve si shkaktar të dëmeve, sepse nuk është fatkeqësi natyrore. Një rast të tillë, kur është zjarri në shumicën e rasteve duhet me u adresuar tek KEDS-i, e jo me u adresuar te komisioni. Ne si komision e bëjmë si vlerësim, po vlerësimi jonë realisht nuk e merr rrugën e duhur. Ne e adresojmë, në Agjencionin për Menaxhim Emergjent, po të njëjtat na kthehen prapë. Po ashtu edhe rastin biznesit që është “Paloma Diora SHPK”. Po thuajse rasti është i njëjtë, Besnik sikur me atë që e parashtroi asambleisti Demokrat dhe ai ka pasur realisht dëme prej energjisë elektrike.

z.Shefqet Krasniqi: Nëse një familjes i ka ndodh një fatkeqësi natyrore. Komisioni pas vlerësimit hipotetizohet e ka gjetur një vlerë për dëmshpërblim rreth 5000 euro. Por, familja të cilës ju ka shkaktuar dëmi konsideron që vlera është më e madhe. Kush e shqyrton këtë ankesë, nëse jam i qartë?

znj.Albulenë Emini: Kjo që po thoni se Komisioni ndoshta vendos vlera paushalle, nuk është e vërtetë, sepse ne si Komision jemi të obliguar me e vizituar palen, pavarësisht dëmit a është në ekonomi familjare, a është në biznes apo është në bujqësi. Kështu që ne si Komision e kemi një çmimore që na vjen prej Ministrisë së Bujqësisë, në rastet e bujqësisë, ndërsa në rastet e ekonomive familjare jemi të obliguar me i përcjell çmime të tregut. Të gjitha pajisjet që i

shkaktohen dëm atij personi apo qytetari të Komunës, i vendoset vlera totale e dëmit të shkaktuar edhe ni kopje e atij vlerësimi i dorëzohet palës. Pra kur vje puna ta ankesa, te cilen ju po e potenconi, Komuna nuk ka Komision të dytë që e shqyrton vlerësimin e Komisionit për fatkeqësi natyrore apo fatkeqësi tjera. Realisht nuk ekzistojnë dy komisione në këtë rast.

z.Shefqet Krasniqi: Nuk thashë që është e vërtetë por e pavërtetë, sepse unë bëra vetëm pyetje.

znj.Albulenë Emini: E vërteta e krejt kësaj është që Komisioni as edhe njëherë të vetme nuk vendos diçka që është në vlera apo në shuma paushalle.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Faleminderit zyrtares për sqarimet. Po e hedhë në votim këtë raport.

***Kuvendi Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Raportin e Komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësit natyrore dhe fatkeqësive tjera në Komunën e Shtimes për vitin 2025 dhe muajin Janar 2026, si vijon:**

1. Dëmet e përgjithshme në Ekonomit Familjare	69,960.23 €
2. Dëmet e përgjithshme në sektorin e Bujqësis	37,991.96 €
3. Dëmet e përgjithshme në sektorin e Biznesit	5,480.00 €
TOTALI.....	113,432.19 €

Pika 13

Raporti Periodik për zbatimin e Rekomandimeve të ZKA-së

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Fjalën ja dha znj.Erza Salija.

znj.Erza Salija: Atëherë unë kam një pyetje për Drejtorin e Financave. Bazuar në raportin e ZKA-së, ku është theksuar se Komuna e Shtimes ka efikasitet të ulët në menaxhimin e llogarive të arkëtushme, këto llogari përfaqësojnë të hyra që i takojnë Komunës tonë, mjete të cilat ne mundemi të i shfrytëzojmë për projekte që janë në të mirë të qytetarëve. Pyetja ime është se pse ZKA ka konstatuar efikasitet të ulët në menaxhimin e këtyre llogarive? A ka mungesë të stafit në menaxhimin e këtyre llogarive apo është në pyetje pa përgjegjshmëria e debitoreve?

z.Besnik Ahmeti, DBF: Ky raport i ka pasur 5 rekomandime, 5 rekomandime janë të reja dhe 4 të përsëritura. Në vazhdim lexoi materialin (shih dokumentin).

z.Muhamet Ademaj: Vetë natyra e punës së Auditorit është e tillë që duhet të hulumtojë të gjeturat dhe t'ju japë rekomandimet. Ky raport mund të lexohet dhe të dëgjohet dhe në asnjë mënyrë të ndryshohet, sepse nuk është përgjegjësi e Kuvendit apo anëtarëve të Kuvendit ta ndryshojë. Të gjitha të gjeturat janë reale. Kërkojmë nga ekzekutivi që rekomandimet e auditorit të përgjithshëm t'i zbatojë.

znj.Fatlinda Rrafshi: Nëse të gjeturat kanë qenë edhe në vitin 2024, çka nëse do të përsëriten edhe në raportin e radhës të ZK-së? Si do të arsyetohet mosmarrjen e masave dhe implementimin e rekomandimeve?

z.Haqif Arifi: Domethënë këtu kemi pasur kryesisht vonesa në pagesa. Po është pozitive se prej 9 rekomandimeve 4 janë realizuar. Një pyetje të shkurtër kur do të bëhet mbyllja përfundimisht investimeve, sepse ata që janë ekonomistët e dinë fort mirë që kjo ka ndikim edhe në pasqyrën e financiare?

z.Besnik Ahmeti, DBF: Ne kena kërkuar tek Ministría që ato projekte që kanë përfunduar me na sjellë dokumentat që me i mbyllë në sistemin e pasurisë. Po përgjigjen që kena marrë prej tyre është se janë lëndë të vjetëra edhe s'mundemi me i gjetë se janë ndrru arkivat janë bartë edhe nuk mundemi me i gjetë. Sa i përket kur kryhen vonesat, vonesat derisa të përfundon kontrata kolektive nuk kryhen.

***Kuvendi i Komunës së Shtime, unanimisht miratoi miratoi Raportin periodik për zbatimin e Rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA).**

Pika 14

Draft-Rregullore Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2026 (pas diskutimit publik)

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Pasi që për këtë rregullore nuk ka diskutime po e hedhë në votim.

***Kuvendi i Komunës së Shtime, unanimisht miratoi miratoi Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2026.**

Pika 15

Shqyrtimi i kërkesave

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Askush nuk është duke pretenduar asgjë me bë me çështjen e kërkesave. Kuvendi ka trajtuar kërkesat është e vërtetë. Ajo çfarë ne po duam në këtë rast është është që kërkesat kanë të bëjnë me Kuvend nga ky mandat të procedohen për trajtim në Kuvendin e Komunës. Po para se me u trajtu kërkesat, se e di që pata edhe ankesa lidhur me materialin, ne duhet t'i shfuqizojmë vendimin e vitit 2011 dhe çdo konkluzion tjetër që ka pas të bëjë me ndalimin e kërkesave në Kuvend.

znj.Yllkë Fejzullahu: Cilat kërkesa do të i trajtojë Kuvendi, specifikoje ato? Nuk e di që ka kërkesa që vetëm Kuvendi mundet me i trajtu. Secila kërkesë e ka drejtorinë e vetë përkatëse.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Sot ne nuk do të trajtojmë asnjë kërkesë, për arsye se ne fillimisht duhet me shfuqizu vendimin e vitit 2011. Por në të njëjtën kohë edhe nenin e rregullorës për të cilin ti po flet, për shkak se Kuvendi e ka bë atë nen.

z.Grejtalb Emini: Po tentoni me i shkelë udhëzimet administrative edhe rregullorën e punës së Kuvendit. Atë vendim t'a kemi treguar ne, ti nuk e ke ditur fare që ekziston. Nuk mundesh me shfuqizu një vendim pa e sjellë si pikë të rendit të ditës. Ti as nuk po e dinë se cilat kërkesa mundesh me i shqyrtu në Kuvend.

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Pse mos me trajtu një kërkesë të njerëzve që po të sjellin në Kuvend? Une e pe kuptoj që kjo çështje ju shqetëson. Çdo kërkesë që vjen regjistrohet në sportel, i shkon bashkëpunëtores profesionale të Kuvendit, mandej vjen në Kuvend edhe mandej ju keni me vendos a me trajtu atë kërkesa. Asgjë nuk jemi duke shkelur

z.Haqif Arifi: Unë besoj që të gjitha institucionet edhe Komuna si institucion e ka arkivën. Ku adresohen të gjitha kërkesat edhe kërkesat prej arkivës destinohen aty ku e kanë adresën. Nuk ka nevojë me ardhë në Kuvend asnjë kërkesë, p.sh.e ekzekutivit. Po nuk ka nevojë me shku asnjë kërkesë e Kuvendit në ekzekutiv, kështu që aty është klasifikimi. Aty bëhet orientimi edhe shpërndarja e dokumentacionit sipas adresës që është e shkruar

z.Muhamet Ademaj: Kryesues edhe ti e di mirë që asnjë kërkesë nuk është shqyrtuar në Kuvend pa kaluar nëpër ekzekutiv. Është shumë keq Kryesues që me shkelë rregulloren e punës së Kuvendit edhe me u bazuar gjithmonë te numrat, hajt se i kam unë numrat edhe bëj çka dua. Ne e kemi obligim të gjithë me punu drejtë edhe ndaj qytetarëve, po edhe ndaj ketyre kuvendarëve që janë brenda Kuvendit.

znj.Arbresha Sylja: Po konsideroj që është vetëm një derë që jena duke ja hap qytetarëve. Nuk po thojna mi trajtu kërkesat e ekzekutivi, se ju jeni duke pas keqkuptime po më duket. Kërkesat për ekzekutivin le të rrijnë te ekzekutivi. Mirëpo ne vetëm po dëshirojmë një hapësirë me pas, që nëse dëshiron dikush me ju drejtuar Kuvendit për një çështje, me pas mundësi me ju drejtuar. Ka kërkesa që Kuvendi i trajton edhe ju jep zgjidhje.

z.Demokrat Mujota: A mundemi me më treguar kush e bënë emërtimin e rrugëve? Kush e bënë emërtimin e objekteve të rëndësive të veçanta, objekteve të shkollës? Pse mos me pas të drejten një qytetar për një kërkesë të veçantë me ardhë edhe me dhënë një ide, për një projekt të caktuar në Kuvend edhe ne si asamble me i trajtuar? Mos i merrni këto senet kaq me zell, kështu veç kundër.

znj.Albana Podvorica – Hoxha: Unë po mendoj që kërkesat të cilat janë specifike për Kuvend, me i trajtu këtu, jo të gjitha se sigurisht muret me pas shumë.

z.Besnik Seferi: Parafolësi pyeti se kush e bënë emërtimin e rrugëve, emërtimin e objekteve, ne paraprakisht formojmë një Komision që e përbën pikërisht ky Kuvend, e që del nga ky Kuvend. Nëse është si pikë shqyrtimi i kërkesave, çfarë rëndësie ka nëse e leni pikën pyetje-përgjigje, sepse pikërisht aty kemi bë ne kërkesat, shqyrtimin e kërkesave, çështje të cilat mu personalisht më vijnë prej shumë qytetarëve.

Nënkryetar, z. Adnan Ademi: Edhe në të kalumen ekzekutiv edhe Kuvendi e kanë pa që kërkesa me ju drejtu Kuvendit është gabim. Edhe qeverisja e PDK-së që ka qenë në 2011, ka nxjerrë vendim që kërkesat me shku përmes ekzekutivit. Kur kam ardhë unë si Kryesues i Kuvendit, në bashkëpunim me komplet shefat e grupeve parlamentare e kemi nxjerrë në zyrën time një konkluzion që kërkesat duhet të ju drejtohen drejtorive përkatëse. Dhe kështu është bërë një Komision për ndryshimin e rregullores edhe ndryshimi i rregullorës është votuar. Ju kisha lutë mos i bëni gjërat politike. Unë kam mundur me bërë këtë se i kam pas edhe votat edhe pushtetin, po se kam bërë se nuk është përgjegjësi e imja, ajo është përgjegjësi e ekzekutivit.

Kryesues, z. Rrahman Jakupi: Në vazhdim po i lexoj disa vendime që janë marrë për aprovimin e kërkesave. Kush e ka konstatuar që e kemi shkelur ligjin? Kështu që kjo kërkesa është e arsyeshme dhe legjitime, lidhur me shkeljet ligjore ju lutem, ma leni mua.

z. Grejtalb Emini: A mundem me ditë kush vendos për selektim? Kur vinë kërkesat në Sekretarinë e Kuvendit, cili është organi që i selekton? A ki me bërë një komision prej Kuvendit me shku me i selektu kërkesat? Unë besoj që jo. E dyta nuk mundet sporteli me ta selektu, nuk ka kompetencë.

z. Muhamet Ademaj: Kryesues kur e përmende emrin e Njazi Ademaj, që e ka bërë një kërkesë, unë e di saktë për atë kërkesë se çfarë kërkesë e ka bërë. Ka qenë për me ja dhënë një pronë të bujqësisë, në shfrytëzim në fshatin Gjurmoc. Mirëpo unë e di mirë që fillimisht ajo kërkesë ka kaluar te Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, pastaj ka ardhë në Kuvend. Nuk ka ardhë drejtpërdrejtë në Kuvend ajo kërkesë.

z. Demokrat Mujota: Unë po e shohë që brenga e vetme është bartja e kërkesës prej sportelit deri te zyra e Kryesuesit. Po këtë brengë hjekne.

z. Shefqet Krasniqi: Profesori Haqifi shumë mirë e spjegoj, një kërkesë që vjen në Komunë dhe që duhet me ju përgjigj Kuvendi, të i përgjigjet Kuvendi. Por a ka mundësi që kjo pikë të shtyhet sepse ka paqartësi, dhe nuk po dojme më të vërtetë me dalë keq, sepse qytetarët po na shohin.

Kryesues, z. Rrahman Jakupi: Kemi një propozim që kjo pikë e rendit të shtyhet për seancën e radhës. Po e hedhë në votim propozimin.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht vendosi që pika e rendit të ditës me numër 15 "Shqyrtimi i Kërkesave" të shtyhet për shqyrtim, deri në mbledhjen e radhës të Kuvendit.**

Pika 16

Propozim-Vendim për zgjedhjen e dy përfaqësuesve për Asociacionin e Komunave të Kosovës, (Pikë shtesë)

Kryesues, z. Rrahman Jakupi: Lidhur me prezantimin ose formulën e zgjedhjes së delegatëve të Kuvendit për Asociacionin e Komunave. Po ju lexoj dokumentin ose shkresën që e ka dërguar Asociacioni i Komunave të nderuar, sipas Statutit të Asociacionit të Komunave të Kosovës, numri i delegatëve për Kuvend të Asociacionit është caktuar në bazë të kritereve të shënuara në vijim. Përveç Kryetarit të Komunës, Komunitat i delegojnë për çdo vit anëtarë të Kuvendit si përfaqësues në Kuvendin e Asociacionit. Kërkohet edhe përfaqësimi i partive politike dhe përfaqësimi gjinor. Meqë Kryetari i Komunës është nga LVV-ja shkon, dy anëtarë na takojmë neve mbi bazën e asaj. Kërkoj një nga PDK dhe një nga LDK të propozohet.

z. Besnik Seferi: Ne kemi një propozim është z. Faruk Beqa.

z. Demokrat Mujota: Ne si grup parlamentar e propozojmë kryetarin e Partisë Demokratike të Kosovës, z. Rrahman Jakupin.

znj. Frosina Berisha- Ahmeti: Nga LDK ne e propozojmë z. Shefqet Krasniqin.

z. Besnik Seferi: Të lutna po a nuk ju duket kjo arrogance e votës? Sinqerisht me plot përgjegjësi e themë është turp i turpit. Unë me këtë moment e lshoj seancën e Kuvendit.

z. Shefqet Krasniqi: Atëhere unë si i propozuar tërhiqem nga ky propozim dhe le të mbesin dy kandidatët që ishin të propozuar.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 19 vota "Për", me 0 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim" unanimisht miratoi vendimin për zgjedhjen e 2 (dy) anëtarëve nga Kuvendi i**

Komunës së Shtimes, për pjesëmarrje në takimet e Asociacionit të Komunave të Kosovës, në këtë përbërje:

- 1. z.Rrahman Jakupi (Përfaqësues nga pozita).**
- 2. z.Faruk Beqa (Përfaqësues nga opozita),**

Pika 17

Pyetje-Përgjigje

Kryesues, z.Rrahman Jakupi: Fjalën ja dha znj.Erza Salija.

znj.Erza Salija: Kryesus, unë e bëj pyetjen nëse nëse përgjigja më kthehet drejtëpërdrejtë në Kuvend Komunal edhe jo përmes emailav. Me kërkesë të shumë qytetarëve, pyetja ime është për z.Demokrat Mujota, z.Adnan Ademi, z.Faik Ramadani edhe z.Grejtalb Emini. Në opinionin e gjerë po flitet edhe përflitet që me datë 2 janar 2026, një ditë para seancës për zgjedhjen e Kryesuesit, ka pasur një takim mes këtyre personave që sapo i përmenda me disa ndërmjetësues, ku ka pasur edhe dakordime, për marrëshje mes këtyre personave për zgjedhjen e Kryesuesit. Kërkoj nga këta persona që të prononcohen, të japin më shumë detaje rreth këtij takimi, i cili ka kriju konfuzion te qytetarët.

z.Muhamet Ademaj: Pyetja ime është sa është numri i ekonomive familjare që paguan tarifa për mbeturina?

z.Grejtalb Emini: Unë sinqerisht kam shumë respekt për të dy kolegët ,Adnanin e kam bashkëpunëtor. Po përgjigjen e merr me email.

znj.Erza Salija: Përgjigjen mundesh mbase edhe ma dërgu mua me email, po qytetarëve të Komunës së Shtimes qysh po mendon me ja dërgu?

z.Grejtalb Emini: Besoj që kryetari i partisë tënde e din edhe përgjigjen.

z.Demokrat Mujota: Para këtij takimi ka pasur edhe një takim tjetër që personalisht më ka ftuar profesori Muhamet edhe më ka pyetur se si po ja bëjmë për këtë punë. Edhe unë i thashë unë jam familjar i dëshmorëve, jam familjar i viktimave të luftës edhe në asnjë variant, në asnjë formë nuk jam për me e bllokuar Kuvendin Komunal të Shtimës, pavarësisht që PDK-ja nuk e ka ftuar pushtetin, po e ka ftuar LVV-ja edhe mbi bazën e atyre diskutimeve që kam bërë me profin Muhamet edhe me kolegët e mi ne kemi ardhë me një pikë përfundimtare me Kryetarin e partisë dhe me gjithë grupin e PDK-së, ku kemi marrë vendim që nëse LDK-ja ose LVV-ja qesin dy kandidat, ne mos me propozuar kandidatë po me abstenu. Në të kundërtën, nëse njëra parti propozon kandidatë, kemi me propozuar edhe ne një kandidatë. Më 2 janar e kam marrë një telefonat prej bashkëpartiakit tim për mu taku me dikënd që ka pretenduar që kena mu takuar me z.Qemail Aliun. Unë jam dalë, jam taku edhe m'ka thonë jo, zoti Qemail Aliu nuk është këtu por në Shqipëri. Vend takimi u zgjedhë te Avasi. Mbi bazën e atij takimit është kërku prej meje edhe nga Adnani edhe nga Grejtalbi, se a ka me qenë unë kandidatë i propozuar për Kryesues.Tani kanë vazhduar si me ja bërë për Kuvend si kena numrat për Kuvend, thashë e keni Besnik Seferin, ai ka respekt edhe te anëtarët e LDK-së edhe te anëtarët e PDK-së.Vendoseni Besnik Seferin pa marrëveshje politike shkon Besnik Seferi. Edhe ka ardhur, muhabeti që Besnik Seferi nuk bënë. Është kërkuar në moment të fundit një votë abstenim për Kryesues të Kuvendit. Kushti i Faikit ka qenë që me u përfshi të gjitha projektet dhe, kusht i imi ka qenë që me u bërë një Komision hetimor. Kjo ka qenë e dizajnune kështu, nuk e di se prej kujt. Profi MuhametAdemaj ka thënë që mos u taku as me Adnanin as me Grejtalbin, se z.Qemail Aliu nuk është i informuar. Edhe kjo ka qenë arsyeja pse ne kemi bërë një marrëveshje me LDK-në.

Nënkryetar, z.Adnan Ademi: Po ta jap një këshillë Erza, mos fol me mend të dikujt tjetër edhe me tru të dikujt tjetër. Adnan Ademi është nënkryetar i LVV-së në Shtime edhe ka qenë Kryesues i Kuvendit e ka ardhë bashkë me LDK-në në pushtet. Çështja tjetër është Adnan Ademi ka qenë i deleguar si Kryesues për me negociuar edhe me LDK-në. Pse skena pas marrëveshje nuk është fundi i botës. Çështja tjetër është që detajet e takimeve që fliten politikisht në takime, për mua është ligësi me i diskutuar ato tema. Unë e kam legjitimitetin prej subjektit tem politik me negociuar me secilin subjekt politik për marrëveshje për të mirën e Kuvendit, që ne mendojmë. Kështu që po ta jap një këshillë, çështjet që bëhen konfidenciale mes subjekte

politike mes anëtarëve pak më të lartë nuk janë çështje që diskutohen në Kuvend. Kushdo që bën pyetje hiq se ka ma problem me ju përgjigjë se jam ball hapur edhe ka shumë fjalë që më ngjiten. E dinë krejt rrethi jam kush jam unë, edhe njerëz të LDK-së më njohin shumë mirë.

znj. Erza Salija: Fillimisht unë z. Adnani nuk të kërkova këshill, po te kërkova përgjigje. Une nuk jam kundër marrëveshjeve politike, se ato janë pjesë e demokracisë, po un jam kundër njerëzve që folin ndryshe edhe veprojnë ndryshe, pra nuk janë koherent me ata qka e thonë edhe me atë çka veprojnë.

z. Muhamet Ademaj: Atë ditë që e ka dhënë Bajram Hajrizi betimin, jemi taku në rrugë edhe kemi shku me pi kafe bashkë edhe mja uruar. Na kena bisedu si kolegë edhe brengën më të madhe kemi pas qe Kuvendi mos me shku në zgjedhje. Unë e kam respektin për LDK-në se 4 vite bashkë kemi qenë me një grup parlamentar, dhe nuk kam folur asgjë kundër LDK-së. Nuk e shkeli asnjë fjalë, dhe nuk kam dëshirë me thënë që ka folur kundra z. Ademi dhe z. Emini.

znj. Arbresha Sylja: Nuk keni nevoj me vnu para përgjegjësisë, Erzen se mu dokë pak diskutimi jo adekuat sepse vetëm pyetje bëri Erza. Jam duke e mbrojtë parimisht edhe si femër edhe si anëtare e Kuvendit, kam këtë të drejtë besoj. Ajo e ka konsideruse në një kohë kur keni dëshiruar me bo marrëveshje me LDK-në si tradhit takimin me PDK-në, kaq.

z. Shefqet Krasniqi: LDK -ja ka qenë fortë e interesuar që opinioni të njoftohet me të vërtetën. Në Kuvend, në mënyrë shumë demokratike keni kërkuar që të shtyhet seanca, sepse jemi në rrugëtim për një marrëveshje të mundshme me LDK-në. Dhe pyetja jonë ishte, është dhe do të jetë gjithmonë pse, prej z. Ademi nuk ja thatë që jemi në marrëveshje, në konsulta të mundshme me partitë politike me LDK-në dhe me PDK-në.

Nënkryetar, z. Adnan Ademi: LVV-ja dhe PDK-ja nuk kanë diskutuar për marrëveshje politike. Jam takuar për një kafe me z. Faik Ramadanin, dhe z. Demokrat Mujoten, edhe është diskutuar frika edhe prej anës tonë që Kuvendi nuk guxon të shkoj në zgjedhje. Me LDK-në është negociuar edhe po negociohet ende për bashkëpunim me qeverisë. Unë e kam daj Faikin. Tani s'mundeni me thënë Adnani ka marrëveshje me Faikin. Ne kena me negociuar çdo herë për të mirën e qytetarëve. Asnjëra parti në Kuvend nuk i kemi votat dhe kena me bo shumicën.

z. Grejtalb Emini: Unë kam insistuar në pjesë të këtij takimi, që asnjë person që nuk është pjesë e takimit mos të përmendet. Ne jena subjekt politik, është normal që s'kemi dashur me shku Kuvendi në zgjedhje, pavarësisht që dikush ka menduar se ne dëshirojina me dërgu Kuvendin në zgjedhje. Unë personalisht kam thënë nuk shkojë në zgjedhje. Ka pasë oferta zyrtare nga LVV-ja Vetëvendosje për marrëveshje politike drejtuar LDK-së. Ne jemi duke punuar bashkarisht që mi zbutë dy polet që me ardhë marrëveshja.

z. Faik Ramadani: Unë ambicie politike, pozitë e ç'pozitë, fare nuk kam. Harrova me thënë, mua nuk më ka dërguar partia, dhe nuk kam me i dhënë llogari askujt Une jam taku me dajen, spontanisht Po, elektorati i LDK-ës le ta kuptojmë një gjë, po ka pasë një takim, nuk e kena mohu. Por nuk ka pasë lloj marrëveshje se s'ka pas kërkesa.

z. Atdhe Isufi: LDKja jo që nuk e ka pranuar ofertën, po nuk e ka pranuar nënçmimi. U përmend që LDK-ja po kërkon shumë. Qytetarëve ju keni thënë, kam pas takim me secilin. Me mu personalisht nuk ke pas takim, se mu më pyesin qytetarët, a je taku. Unë mendoj se është takim zyrtar, kur edhe përfaqësuesi i LDK-së takohet për një çështje të caktuar.

Nënkryetar, z. Adnan Ademi: Takimi me Faik Ramadanin edhe Demokrat Mujotën nuk ka qenë takim për marrëveshje. Kuptoni këto njëherë edhe mirë. Çështja tjetër, nëse e kam thënë që çdo asambleistë të LDK-së e kam taku personalisht, unë jam njeri, ndodhta kam mundur me gabuar.

z. Bajram Hajrizi: Unë kam pas pyetje për Kryetarin, për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, për Drejtorinë e Shëndetësisë, për Drejtorinë e Arsimit. Këto pyetje do t'i parashtroj në seancën tjetër

Kryesues, z. Rrahman Jakupi: Pasi që diskutime tjera nuk ka, atëherë po e përfundojë këtë mbledhje në ora 17:56h.

Procesmbajtëse
Sadberë Halili



Kryesuesi i Kuvendit
Rrahman Jakupi

